



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË  
BASHKINË KRUJË**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT FINANCIAR  
NË BASHKINË KRUJË**

**TIRANË, TETOR 2025**

	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	
1.	Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit	2-7
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin e auditimit	
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	8-9
2.	Identifikimi i çështjes	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
4.	Përgjegjësitë e audituesve	
5.	Kriteret e vlerësimit	
6.	Standardet e auditimit	
7.	Metodat e auditimit	
8.	Dokumentimi i auditimit	
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	
<b>1</b>	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	10-10
<b>2</b>	-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit:	
<b>2.1</b>	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit	10-14
<b>2.2</b>	Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.	14-48
<b>2.3</b>	Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.	48-50
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	51-57

## **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit**

#### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit.**

Bashkia Krujë siguron qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet, njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e qeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme; nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore. Bashkia Krujë përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Krujë, Fushë-Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë dhe Cudhi. Në bashkinë e re gjenden dy qytete dhe 50 fshatra. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Krujë të Qarkut Durrës.

#### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.**

Bashkitë janë institucione të rëndësishme të vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë, të cilat sigurojnë qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

Auditimi i këtij institucioni ka rëndësi për Kontrollin e Lartë të Shtetit në kuadër të plotësimit të detyrimit të zbatimit të programit vjetor të auditimeve.

#### **c. Qëllimi i auditimit.**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Auditimi është kryer mbi baze risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat si: verifikim i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, etj.

**e. Nr. i gjetjeve dhe rekomandimeve.** Janë formuluar 10 gjetje dhe rekomandime për masa organizative, 1 gjetje dhe rekomandime për përdorim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë, efektivitet dhe të ardhura të munguara.

## **2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.**

### **a-Përshkrimi i gjetjeve kryesore:**

**Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për marrjen dhe dorëzimin e detyrës, dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës, nga ana e punonjësve që ndërpresin marrëdhëniet e punës, fillojnë punë rishtas, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit.

Gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara për ruajtjen e informacionit elektronik nga ana e punonjësve, gjë e cila ka të bëjë edhe me dorëzimin e këtij informacioni të eprori, apo punonjësi tjetër kur bëhen ndërprerja e marrëdhënieve të punës, apo lëvizjet brenda institucionit. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e bazës së të dhënave për sektorët, apo drejtoritë përkatëse të institucionit, krijojnë vështirësi për vazhdimësinë e punës së kryer dhe transmetimin e saj nga një punonjës te tjetri

**Gjetje nga auditimi:** Faqja elektronike e Bashkisë Krujë nuk funksionon, duke bërë të pa mundur publikimin e dokumenteve zyrtare të bashkisë, e duke mos krijuar për qytetarët mundësinë e marrjes në mënyrë elektronike të informacionit për shërbime të ndryshme, për taksat vendore, për mbledhjet e këshillit bashkiak dhe vendimet e marra, shpenzimet e kryera për projektet publike, pasqyrat financiare, etj

**Gjetje nga auditimi:** Për pjesën më të madhe të pronave dhe të territorit të Bashkisë Krujë, janë miratuar pesë Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), që nga viti 2008 e në vazhdim, përmes të cilave është përcaktuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i kalojnë në pronësi ose përdorim Bashkisë Krujë, ku nuk janë marrë masat e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit teknik e ligjor dhe vijimin e procesit të regjistrimit të pronave në ASHK. Deri më 31.12.2024, vetëm 12 prona janë pajisur me certifikatë pronësie, por asnjë prej tyre nuk është vlerësuar apo regjistruar në kontabilitet. Për vitin 2024 është kryer aplikim në ASHK vetëm për 1 pronë (“Qendra kulturore”), ndërkohë që numri i pronave për të cilat duhej aplikuar nga Bashkia Krujë në ASHK është i konsiderueshëm. Gjatë vitit 2024 nuk është pajisur me dokument pronësie asnjë pronë.

**Gjetje nga auditimi:** Bashkia Krujë nuk ka regjistër kontabël për aktivet, ku të specifikohen në mënyrë analitike sipas llogarive përkatëse përshkrimi aktiveve, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, vlera fillestare, amortizimi, vlera e mbetur, etj. Gjithashtu në llogaritë e pasqyrave financiare nuk gjejnë pasqyrim një numër i konsiderueshëm pronash të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi, apo përdorim të Bashkisë Krujë. Për këto arsye nuk jepet siguri e arsyeshme se llogaritë e aktiveve afatgjata pasqyrojnë vlerën reale të pasurisë së institucionit.

**Gjetje nga auditimi:** Për taksapaguesit familjarë për taksat dhe tarifatat vendore Bashkia Krujë nuk ka hartuar regjistër të taksapaguesve, nuk administron listë të debitorëve familjar as për debinë progresive dhe as për debinë e vitit buxhetor 2024, duke mos patur të dhëna për numrin e familjeve që kanë detyrim për të paguar, vlerën e detyrimit që kanë, numrin e familjeve që janë debitorë, vlerën e debisë dhe llojin e taksës për të cilin janë debitorë.

**Gjetje nga auditimi:** Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” sipas të dhënave të pasqyrave financiare, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 907,716,343 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore dhe kontabilizuar në pasqyrat financiare. Kjo vlerë ka një rritje prej 74,598,536 lekë, krahasuar me vitin 2023, në të cilin ka qenë 833,117,807 lekë. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Financës, vlera progresive prej 907,716,343 lekë përbëhet nga detyrimi prej 714,893,238 lekë për taksat dhe tarifatat vendore nga subjektet private, detyrimet e lëna ndër vite nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në vlerën 114.548.525 lekë, si dhe vlera e pa arkëtuar e gjobave të IMT-së, prej 78,274,580 lekë. Duke qenë se vlera e gjobave të IMT prej

78,274,580 lekë, me ndryshimet e fundit ligjore janë falur, vlera konkrete e debitorëve ndaj bashkisë është 829,441,763 lekë.

#### **b. Përshkrimi i rekomandimeve kryesore**

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturës së burimeve njerëzore, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave të shkruara, lidhur me detyrimet që kanë punonjësit të cilët fillojnë punë rishtas, ndërpresin marrëdhëniet e punës, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit, për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal.

**Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë të merren masa për vendosjen në funksionim të faqes elektronike të Bashkisë Krujë, me qëllim publikimin e dokumenteve dhe informacioneve të ndryshme, si dhe aksesimin nga ana e qytetarëve të këtyre informacioneve.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përkatëse që mbulojnë administrimin e pronave në bashki, për pronat të cilat kanë kaluar me VKM në pronësi, apo përdorim të Bashkisë Krujë, të marrin masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe të kryejnë aplikimin për regjistrimin e tyre në ASHK.

**Rekomandim:** Drejtoria e Financës të marrë masa për hartimin e regjistrimit të aktiveve, duke përcaktuar përshkrimin e aktivitetit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vitin e origjinës (hyrjes), etj.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Krujë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, në përbërje të të cilët të jenë edhe specialist nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me qëllim hartimin e regjistrimit të taksapaguesve familjar për tasat dhe tarifatat vendore.

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Krujë së bashku me strukturat përkatëse të institucionit, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore në rend shterues, për arkëtimin e vlerës progresive debitorë prej 829,441,763 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore dhe e kontabilizuar në pasqyrat financiare.

### **3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinionin i auditimit**

#### **OPINION I AUDITIMIT**

##### **Opinionin mbi pasqyrat financiare të vitit 2024.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Krujë për vitin ushtrimor 2024, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, etj., si dhe shënimet shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, shprehim një opinion **të kualifikuar<sup>1</sup> (me rezervë)**, për llogaritë vjetore të Bashkisë Krujë, duke arritur në përfundimin se anomali të e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura në llogaritë vjetore të vitin 2024, të shprehura në bazën për opinionin.

##### **Baza për dhënien e opinionin mbi pasqyrat financiare.**

<sup>1</sup> SNA-705-Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar kur ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë..

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, etj.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 20 milion lekë, si dhe anomalitë e konstatuara, si vijon:

- Për pjesën më të madhe të pronave dhe të territorit të Bashkisë Krujë, janë miratuar pesë Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM), që nga viti 2008 e në vazhdim, përmes të cilave është përcaktuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i kalojnë në pronësi ose përdorim Bashkisë Krujë, ku nuk janë marrë masat e nevojshme për përgatitjen e dokumentacionit teknik e ligjor dhe vijimin e procesit të regjistrimit të pronave në ASHK. Deri më 31.12.2024, vetëm 12 prona janë pajisur me certifikatë pronësie, por asnjë prej tyre nuk është vlerësuar apo regjistruar në kontabilitet.

- Bashkia Krujë nuk ka regjistër kontabël për aktivet, ku të specifikohen në mënyrë analitike sipas llogarive përkatëse përshkrimi aktiveve, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, vlera fillestare, amortizimi, vlera e mbetur, etj. Gjithashtu në llogaritë e pasqyrave financiare nuk gjejnë pasqyrim një numër i konsiderueshëm pronash të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi, apo përdorim të Bashkisë Krujë, por për arsye se nuk janë ta pajisura me certifikatë pronësie dhe nuk janë vlerësuar, nuk janë as të kontabilizuara. Për këto arsye llogaritë e aktiveve afatgjata nuk pasqyrojnë vlerën reale të pasurisë së institucionit.

- Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në pasqyrat financiare të viti 2024 ka vlerën 179,163,908 lekë, prej së cilës gjatë vitit 2024 është shtuar vlera 42,423,704 lekë, por për këtë llogari nuk ka informacion të detajuar lidhur me listën e projekteve që përbëjnë vlerën 179,163,908 lekë, nuk ka inventar, analizë të kësaj llogarie. Nuk ka informacion të saktë se cilat janë projektet, investimet e të cilave kanë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim në mënyrë përfundimtare, si dhe përse vlera e projektit nuk është bashkuar me vlerën e investimit në llogarinë përkatëse të tij.

-Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve në masën 5% të vlerës së kontratës për 52 objekte, në vitin 2024 ka vlerën 82,296,357 lekë, prej së cilës vlera 24,336,448 lekë i përket vitit 2024, për 30 objekte. Për këtë llogari nuk ka informacion të saktë për rastet e investimeve të cilave ju ka kaluar afati i garancisë së punimeve i përcaktuar në kontratë, me qëllim xhirimin e fondeve në llogari të kontraktorit, apo përfitimin e tyre nga institucioni, në rastet e parashikuara në kontratë.

- Nga analizimi i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, u konstatua se Bashkia Krujë nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, duke patur një vlerë progresive të pa arkëtuar prej 829,441,763 lekë, e cila përbënë të ardhura të munguara për njësinë vendore, prej së cilës vlera 714,893,238 lekë i përket taksave dhe tarifave vendore.

## **II.HYRJA**

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit Nr. 615/1, datë 30.05.2025 i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, nga data 05.06.2025 deri në datën 14.07.2025, në subjektin Bashkia Krujë u krye auditimi financiar, i cili mbuloi periudhën prej 01.01.2024 deri më 31.12.2024.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

B. M. (Përgjegjës Grupi), J. P. (në fazën e terrenit), R. L, auditues.

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

**Objektivi i auditimit financiar** është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

**Qëllimi i auditimit:** Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

**Identifikimi i çështjes:** Sipas veprimtarisë së subjektit, janë vlerësuar fushat me risk të cilat përbëjnë drejtimit e auditimit, të miratuara në programin e auditimit, si më poshtë:

Mbi vlerësimin e funksionimit të MFK dhe auditit të brendshëm;

Procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;

Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Krujë.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së.**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar.

Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe auditimin e përputhshmërisë për fushat e auditimit dhe, i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

**Kriteret e vlerësimit.**

Kriter vlerësimi është i gjithë kuadrin rregullator në fuqi (baza ligjore, aktet e brendshme të institucionit, kushtet e kontratës etj., me të cilat krahasohet aktiviteti i njësisë vendore që auditohet) dhe kryesisht:

Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;

Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, etj.

Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”;

VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”. i ndryshuar;

VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim.

Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

Udhëzimi i MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njërive të vetëqeverisjes vendore”;

Rregullore e procedurave të auditimit në KLSH, miratuar me vendimin nr. 07, datë 17.01.2024 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Krujë, etj

Manual Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Manuali i Auditimit Financiar i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Manuali i Auditimit të Zbatimit të Rekomandimeve i Kontrollit të Lartë të Shtetit, etj.

**Standardet e auditimit të aplikuar:** Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit IFAC;

**Metodat e auditimit:** Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme cilat do të përbëjnë një bazë të arsyeshme për vlerësimet dhe përfundimet e auditimit (ISSAI 300, 3.5.1).

Auditim është kryer me zgjedhje, bazuar në rrishtun e vlerësuar.

Për arsye se në bazë të vlerësimit sistemi i kontrollit të brendshëm është përcaktuar jo në nivelin e duhur (rrishtun në nivelin mesatar), grupi i auditimit u mbështet më shumë në procedurat thelbësore dhe më pak në qasjen e mbështetur në sistemin e kontrollit të brendshëm. Siguria e auditimit është marrë më shumë nga testet e kontrolleve, ose procedurat thelbësore të cilat përfshijnë testet e detajeve dhe procedurat analitike. Metodatat kryesore të auditimit që u përdorën: ri performanca, kërkimi i të dhënave nëpërmjet pyetësorëve, intervistimet, llogaritjet (kontrollet aritmetike të shumave), inspektimi (ekzaminimi i dokumentacionit financiar, fatura, regjistrime dhe dokumente etj.), konfirmim nga të tretët, raporte dhe informacione, pyetësorët etj.

**Dokumentimi i auditimit:** Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e auditimit. Janë plotësuar dokumentet standarde deri në këtë fazë të auditimit.

### **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.**

Bashkia Krujë siguron qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet, njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e qeverisjes vendore; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme; nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore. Bashkia Krujë përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Krujë, Fushë-Krujë, Bubq, Nikël, Thumanë dhe Cudhi. Në bashkinë e re gjenden dy qytete dhe 50 fshatra. Të gjitha njësitë janë pjesë e Rrethit Krujë të Qarkut Durrës.

#### **2-Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit.**

##### **Pika 1 e programit të auditimit: Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.**

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:  
Rregullore e brendshme për funksionimin e administratës së Bashkisë Krujë.

Kodi i etikës.

Struktura e bashkisë.

Deklarata për cilësinë e kontrollit të brendshëm

Urdhri për krijimin e grupit të menaxhimit strategjik.

Dokumente të tjera të përshkruara përgjatë materialit.

Informacioni elektronik i përgatitur nga Bashkia Krujë, në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga grupi i auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se bashkia Krujë ka marrë masa për hartimin dhe implementimin e 5 elementëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit të brendshëm, por evidentohen edhe disa mangësi në këtë proces, të trajtuara në vijim:

##### ***1-Mjedisi i kontrollit***

Bashkia Krujë funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë, referuar në vendimin nr. 04 datë 09.01.2024, “*Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Krujë*”. Përmbajtja e rregullores i përgjigjet strukturës aktuale që ka Bashkia Krujë,, sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës. Në rregullore janë përcaktuar misioni, të drejtat dhe përgjegjësitë e njësisë vendore, funksionet e saj, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave përkatëse, etj.

A janë miratuar nga titullari standardet e sjelljes, apo kodi i etikës për punonjësit e institucionit?  
Në cilin dokument dhe vit është bërë miratimi?

Me vendim të Kryetarit të Bashkisë nr.5, datë 09.01.2024, është miratuar Kodi Etik në Bashkinë Krujë. Në të cilin janë përcaktuar standardet e sjelljes së punonjësve të institucionit, Bashkia Krujë nuk ka rregullore të brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat, duke mos garantuar sigurinë e duhur për arkivimin, ruajtjen e administrimit të dokumenteve dhe për dëmtimin ose humbjen e tyre. Mos hartim i rregullores së brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat, është në kundërshtim ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 42 (Ruajtja dhe administrimi i dokumenteve financiare), ku thuhet:

*1. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjëse për arkivimin, ruajtjen e administrimit të dokumenteve financiare dhe për dëmtimin ose humbjen e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

2. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore miraton rregulloren e brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat.

Nga Titullari është ngritur Ekipi i Menaxhimit të Programeve dhe Grupit të Menaxhimit Strategjik GSM për vitin 2024 është mbledhur për PBA-në hartimin e buxhetit dhe paketën fiskale.

Me shkresën nr.214, Prot., datë 12.01.2024, është miratuar “Programi vjetor i punës i bashkisë për vitin 2024”, ku janë përcaktuar objektivat dhe prioritetet kryesore të institucionit për vitin 2024.

Janë marrë masa për ruajtjen dhe rritjen e nivelit profesional të punonjësve, pasi janë evidentuar nevojat për trajnime për punonjësit, dhe është miratuar plani i trajnimeve për vitin 2024, i ndarë për secilën drejtori. Në bashkëpunim me DAP dhe ASPA është realizuar procesi i trajnimeve për punonjësit dhe ata të punësuar rishtazi, duke ndërmarrë hapat dhe procedurat sipas përcaktimeve në ligjin për nëpunësin civil.

Për punonjësit të cilët ndërpresin marrëdhëniet e punës, në urdhrin e dorëzimit nga titullari cilësohet detyrimi i punonjësit për dorëzimin e aktiveve që ka patur në dorëzim, por në asnjë akt të brendshëm, nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal (dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës, pra të gjithë punën e krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion), nga ana e punonjësve që ndërpresin marrëdhëniet e punës, fillojnë punë rishtas, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit (lëvizje paralele, ulje, apo rritje në detyrë). Gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për ruajtjen e informacionit elektronik nga ana e punonjësve, gjë e cila ka të bëjë edhe me dorëzimin e këtij informacioni të eprori, apo punonjësi tjetër kur bëhen ndërprerja e marrëdhënieve të punës, apo lëvizjet brenda institucionit.

Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e bazës së të dhënave për sektorët përkatës të institucionit, krijojnë vështirësi për vazhdimësinë e punës së kryer dhe transmetimin e saj nga një punonjës te tjetri dhe janë në kundërshtim me:

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 13 ku përcaktohet:

*“Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve”.*

-VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, pika 50 ku përcaktohet:

*“Nëpunësi duhet të bëjë tek eprori direkt dorëzimi e plotë të dokumentacionit që ka për shkak të detyrës, si dhe të njësisë përgjegjëse për mbajtjen e inventarit fizik, dorëzimin e pajisjeve dhe të mjeteve të punës në inventar”.*

-Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25 “Detyrimi i dhënies llogari dhe i kthimit”, ku thuhet:

1. Punëmarrësi i jep llogari punëdhënësit për gjithçka të përfituar në emër të punëdhënësit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij brenda kontratës, veçanërisht për shumat në para.

2. Punëmarrësi i kthen menjëherë punëdhënësit gjithçka të marrë, me përjashtim të bakshisheve dhe dhuratave vetjake për të.

3. Punëmarrësi i kthen punëdhënësit menjëherë edhe gjithçka të prodhuar nga veprimtaria e tij në bazë të kontratës.

### **Menaxhimi i riskut**

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet

për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Nga Bashkia Krujë është hartuar për vitin 2024 regjistri i riskut.

Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatori i Riskut është kompetencë e cila është deleguar nga Kryetari i Bashkisë për vitin 2024 sipas urdhrin nr. 20 datë 18.01.2024, te znj.

E.F., nëpunës zbatues.

Është ngritur GMS me urdhrin nr.14, date 18.01.2024, por nuk ka takime pune (mbledhje) prej tij me objekt analizimin për çështjet e menaxhimit të riskut, sugjerimin e masave për minimizimin e rrisqeve që rrezikojnë realizimin e objektivave. Gjithashtu nuk janë kryer trajnime lidhur me menaxhimin e riskut, apo për 4 elementët e tjerë të MFK, për anëtarët e GMS, me qëllim që njohja sa më e mirë nga ana teorike të çështjeve të MFK, të ndihmojë në kryerjen e detyrave në praktik në këtë fushë.

### **Aktivitetet e Kontrollit**

Aktivitetet e kontrollit kanë të bëjnë kryesisht me miratimin e procedurave dhe politikave të shkruara para faktit dhe pas faktit, për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut

Është bërë ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

Është miratuar sistemi i dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nëpunësit autorizues dhe të nëpunësit zbatues të njësisë.

Nuk u paraqit dokumentacion që të vërtetojë se nga titullari janë miratuar rregullat për garantimin e ruajtjes së informacionit dhe të aktiveve të njësisë.

Mangësitë lidhur me aktivitetet e kontrollit janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 22.

### **Informacioni dhe komunikimi**

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre.

Menaxhimit (titullarit, drejtorëve, pra sipas shkallës hierarkike), duhet t'i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë, në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet. Se cilat janë këto lloj raporte dhe sa herë gjatë vitit duhet të përgatiten, duhet të jenë shkruar dhe miratuar në dokumente të brendshme të institucionit.

Të gjithë punonjësit duhet të njihen me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem (cilat raporte ka për detyrë të hartojë për eprori, dhe cili është afati i hartimit të këtij raporti). Falë komunikimit ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë. Prandaj, titullari dhe punonjësit janë pjesë e rrjetit të komunikimit. Titullari duhet të marrë informacione të sakta, të vërteta, të përshtatshme dhe në kohën e duhur mbi të gjithë aktivitetin e njësisë. Transmetimi i informacionit nga poshtë-lart, sipas hierarkisë, është metoda më e përhapur e komunikimit (komunikimi nga vartësi te eprori, pra vertikal). Nga ana tjetër, titullari duhet t'u japë punonjësve informacionet e duhura, që këta të marrin vendimet e duhura si

dhe të formulojë mesazhe dhe detyra të qarta e direkte për punonjësit, që këta të fundit t'i zbatojnë ato në mënyrën e duhur. Ekzistenca e një komunikimi horizontal efektiv është e një rëndësie esenciale për të marrë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave (rasti i hartimit të regjistrit të taksapaguesve, rasti i hartimit të kontratave të qirave, etj.). Kjo kërkon një ndërveprim të mirë dhe shkëmbimin në kohë të informacionit ndërmjet strukturave, njësive dhe punonjësve të ndryshëm që gjenden në të njëjtin nivel të hierarkisë së njësisë.

Është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit.

Faqja Ëeb e Bashkisë Krujë nuk funksionon, duke mos dhënë mundësinë e afishimit për publikun të dokumenteve të ndryshme të institucionit, si VKB, buxhetin, pasqyrat financiare, etj. Nuk është ngritur një sistem deklarimi efikas, i cili duhet të përfshinte nivelet dhe afatet për deklarimin, llojet e deklaratave që i dorëzohen titullarit nga menaxherët kryesor, shpeshësia e këtyre raportimeve (për raporte, mujore, tre mujore etj.), në mënyrë që të vlerësohet dhe të mbikëqyret efënca dhe efektiviteti i veprimtarive të secilit sektor, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e të nenit 23 të MFK. Nuk ka të përcaktuar në detyrat e asnjë menaxheri se çfarë raportesh duhet të përgatisë për titullarin dhe në çfarë intervali kohe duhet ti përgatisë.

Nga titullari nuk janë miratuar gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë vendore dhe që sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike, dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.

**Përgjegjësia për miratimin e gjurmës së auditimit i takon titullarit, ndërsa përgjegjësia për mos hartimin e tyre është e drejtorëve të drejtorive dhe përgjegjëseve të sektorëve, sipas strukturës së aparatit të Bashkisë Krujë për vitin 2024.** Gjurmët e auditimit duhet të përgatiten nga menaxherët (drejtorët e drejtorive, apo përgjegjësat e sektorëve, në rastin kur struktura është në nivel sektori), për proceset kryesore të punës dhe është përgjegjësi e NA të njësisë të sigurojë se këto procese janë identifikuar dhe janë përgatitur gjurmët e auditimit për to.

Gjurmët e auditimit duhet të përfshijnë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. Informacioni i marrë nga gjurma e auditimit i jep mundësinë titullarit, ose audituesit të përcaktojë radhën e ngjarjeve që ndodhin brenda çdo procesi. Një gjurmë auditimi bën të mundur identifikimin e aktiviteteve, të personave që i zbatojnë ato dhe të personave që janë përgjegjës për to. Ndërtimi dhe përgatitja e një gjurme auditimi mbështetet në analizën e procesit dhe synon përshkrimin dhe paraqitjen grafike të ecurisë së aktiviteteve, dokumenteve dhe të dhënave si dhe identifikimin e qartë të operacioneve që zbatohen, strukturave të përfshira në këto procese, etj.

**Gjurma e auditimit pas miratimit duhet të arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi.**

**Mos përgatitja nga menaxherët (drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve) i gjurmës së auditimit, për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë, i ngarkon ata me përgjegjësi (sipas strukturës së miratuar të Bashkisë Krujë për vitin 2024), si dhe është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16, pika 2 dhe 3 ku thuhet:**

*“...Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit.*

**3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi**

Për fushën e IT sistem rezerve back-up ka vetëm sistemi i taksave në Drejtorinë e Tatim Taksave Vendosur në Njësinë Administrative Fushë Krujë, por jo strukturat e tjera të njësisë vendore, duke

mos garantuar ruajtjen e informacioneve nga cenimi apo humbja e të dhënave si pasojë e mungesës së procedurave të rikuperimit në raste fatkeqësie, etj.

Mangësitë e mësipërme janë në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 23.

### **Monitorimi**

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Elementët kryesor të monitorimit janë:

Monitorimi i përditshëm – kryhet nga menaxherët gjatë zbatimit të punës ditore (kontrolli mbi dokumente, vendime, veprime etj.).

Monitorimi periodik – përmes raporteve, analizave dhe vlerësimeve (mujore, tremujore, vjetore).

Përdorimi i treguesve të performancës – për të matur se sa mirë funksionojnë proceset.

Vlerësimi i kontrollit të brendshëm – për të parë nëse duhet rishikuar apo përmirësuar ndonjë pjesë e sistemit.

Përfshirja e auditimit të brendshëm – si një formë e veçantë e monitorimit të pavarur.

A janë plotësuar deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti vjetor dhe pyetësi i vetë-vlerësimit për vitin 2024 dhe a janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afatit ligjor

Janë plotësuar deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti vjetor dhe pyetësi i vetë-vlerësimit për vitin 2024 dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afatit ligjor.

Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm janë përfshirë në raportin vjetor të veprimtarisë e të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe pasqyrohen në hapat e planit të veprimit për të ardhmen.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z.A.B., nëpunësi zbatues z. E.F., si dhe drejtorët e aparatit të bashkisë sipas strukturës së miratuar (për mos hartimin e gjurmës së auditimit në drejtoritë e tyre, etj).

***Sa më sipër arrihet në konkluzionin se*** nuk është ngritur një sistem i plotë i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, pasi nuk ka një paketë të plotë rregullash të shkruara për të gjithë elementët e këtij sistemi, veprime apo mos veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 8, 9, 10, 11, 20, 21, 22, 23, 24, si dhe me Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, miratuar me urdhrin e MFE nr. 108, datë 17.11.20216.

### **Pika 2 e programit të auditimit. Auditim i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.**

Në bazë të programit të auditimit nr. 615/1, datë 30.05.2025, me objekt: “*Auditim financiar në Bashkinë Krujë*”, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, u auditua pika 2 e Programit të Auditimit, “*Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore*”, nënpikat:

2.2. Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:

- Llogarive të arkëtueshme;
- Llogarive të pagueshme.

2.3. Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat;

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

### **U shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:**

- Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël;
- Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare;
- Dokumentacioni i mbajtur mbi përlllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve;
- Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët;
- Dokumentacioni i mbajtur mbi realizimin e procesit të inventarizimit;
- Urdhër shpenzimet dhe transaksionet financiare;
- Dokumente të tjera në lidhje me veprimtarinë financiare të institucionit.

### **Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2024:**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme””, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 2428 prot., datë 28.03.2024, të përbëra si vijon:

Formati nr. 1: Pasqyra e pozicionit financiar;

Formati nr. 2: Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike);

Formati nr. 3: Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou);

Formati nr. 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto;

Formati nr. 5: Pyetësor dhe shënimet shpjeguese;

Formati nr. 6: Investimet dhe burimet e financimit;

Formati nr. 7/a: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike);

Formati nr. 7/b: Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto);

Formati nr. 8: Numri i punonjësve dhe fondi i pagave;

Pasqyrat financiare janë nënshkruar nga z. E.F., si Nëpunës Zbatues dhe Kryetar i Bashkisë z. A.B., Nëpunës Autorizues.

### **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2024:**

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 73-106, ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 578, datë 30.10.2023 “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë, afatshkurtër e materiale për periudhën 01.01.2023-31.12.2023” dhe është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen fizike të aktiveve me gjendjen kontabël, i përbërë nga 5 anëtarë, përfunduar në datën 19.06.2024, referuar relacionit mbi kryerjen e procesit të nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi nr. 3858 prot., datë 19.06.2024.

Procedura e mësipërme për kryerjen e inventarizimit, sipas urdhrit të titullarit nr. 578, datë 30.10.2023, e cila ka filluar në vitin 2023 dhe ka përfunduar në vitin 2024, është kryer për llogari të vitit ushtrimor 2023.

Nga auditimi konstatohet se nuk është kryer inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, si dhe aktiveve afatshkurtra për vitin ushtrimor 2024, pasi nga titullari i institucionit nuk ka dalë urdhër për këtë qëllim. Për këtë arsye nuk është verifikuar saktësia e ekzistencës së aktiveve, cilësia e gjendjes fizike të tyre, si dhe përdorimi në mënyrën e duhur dhe me efikasitet të aktiveve për vitin 2024. Mos verifikimi i ekzistencës së aktiveve nëpërmjet procesit të

inventarizimit, nuk garanton ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve kundrejt humbjeve, keq përdorimeve, apo përdorimit të pa autorizuar, si dhe nuk garanton ekzistencën e aktiveve, duke mos u siguruar se vlerat kontabël të aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar, përputhen me vlerat dhe gjendjen fizike faktike të tyre, pasi në këto llogari është pasqyruar gjendja kontabël, pa u ballafaquar me gjendjen faktike fizike.

Mos kryerja e procesit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2024, është në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar: - pika 73 dhe 74, pika 24; neni 12, pika 3.f, të ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Për mos kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin ushtrimor 2024, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. A.B., si dhe nëpunësi zbatues, z. E.F..

### **Mbajtja e kontabilitetit për vitin 2024:**

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, arkën, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, u konstatua se:

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet =	9,397,679,569 lekë
Aktivet	10,458,225,199 lekë
Pasivet	1,600,545,630 lekë
Aktivet neto	9,397,679,569 lekë

### **Aktivet afatshkurtra:**

Aktivet afatshkurtra në datën 31.12.2024 paraqiten në vlerën **3,054,901,128 lekë** dhe përbëhen nga: Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”, në shumën 1,995,080,959 lekë, Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, në shumën 81,570,896 lekë, Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme”, në shumën 978,249,273 lekë.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore 2024, sipas Formatit nr. 1, Pozicioni Financiar, paraqitet në aneksin bashkangjitur raportit të auditimit.

### **Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:**

Llog. kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
56	Mjete monetare ne bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	1,995,080,959	1,000,709,250	994,371,709
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	0	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>1,995,080,959</b>	<b>1,000,709,250</b>	<b>994,371,709</b>

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 1,995,080,959 lekë, sipas akt rakordimit me Thesarin përbëhet nga: gjendja e Llogarisë 85 “Rezultati i vitit ushtrimor” në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar”, në vlerën 1,912,855,631 lekë (të ardhura të trashëguara të paçelura 190,084,974 lekë, granti i papërdorur në vlerën 1,463,041,373 lekë dhe të ardhura të papërdorura në vlerën 259,729,284 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 “Mjete në ruajtje”, në shumën 82,296,357 lekë, minus ndryshimin e gjendjeve të inventarit që në fund të vitit paraqitet me pakësim në vlerën 10,692,310 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr. 3 “Pasqyra e flukseve monetare (Cash-Flow) sipas

metodës direkte” (Teprica në fillim të vitit në vlerën 1,000,709,480 lekë - Transferta të tjera në vlerën -13,380,962 lekë - Veprimtaritë e investimeve në vlerën -243,890,962 lekë + Fondet buxhetore për shpenzime korrente në vlerën 547,706,560 lekë + arkëtimet e hyra cash në vlerën 2,391,604,754 lekë - Pagesa për detyrime e shpenzime korrente në vlerën 1,687,667,911lekë), të paraqitura në aneksin e raportit të auditimit.

Llogaritë e klasës 5 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

### Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhen nga:

Llog. kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
31	Materiale	13,659,346	11,182,737	2,476,609
32	Inventar i imët	67,911,550	81,080,469	-13.168,919
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri	0	0	0
37	Gjendje te pambritura ose pranë të tretteve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>81,570,896</b>	<b>92,263,206</b>	<b>-10,692,310</b>

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar në datën 31.12.2024, paraqiten në vlerën 81,570,896 lekë dhe përbëhen nga llogaria 31 “Materiale” në vlerën 13,659,346 lekë dhe nga llogaria 32 “Inventar i imët”, në vlerën 67,911,550 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën -10,692,310 lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 10,692,310 lekë.

**Llogaria 312 “Materiale”,** ka vlerën 13,659,346 lekë, e cila është e barabartë me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordinin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material. Lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2024	<b>11,182,737</b>
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2024	44,432,329
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024	41,955,720
<b>Gjendja në 31.12.2024</b>	<b>13,659,346</b>

**Llogaria 32 “Inventar i imët”,** ka vlerën 67,911,550 lekë vlerë e cila është e barabart me vlerën e dokumentuar në përmbledhësen dhe aktrakordinin e mbajtur në fund të vitit me komisionin dhe përgjegjësin material dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	<b>81,080,469</b>
Hyrje gjatë vitit 2024	6,445,367
Dalje gjatë vitit 2024	19,614,286
<b>Gjendja në 31.12.2024</b>	<b>67,911,550</b>

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”, përbëhen nga:**

Llog. kontabël	Emertimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca 2024-2023
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>	<b>978,249,273</b>	<b>920,150,260</b>	
411	Klientë e llogari te ngjashme			0
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba			0
431	Tatime e taksa			0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal			0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti			0
435	Sigurime Shoqërore			0
436	Sigurime Shëndetësore			0
437,438	Organizma te tjerë shoqërore			0
44	Institucione te tjera publike			0
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes			0
468	Debitorë te ndryshëm	907,716,343	833,117,807	74,598,536
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	70,532,930	87,032,453	(16,499,523)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit			0
49	Shuma te parashikuara per zhvleresim(-)			0
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore			0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin			0
477	Diferenca konvertimi aktive			0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime			0
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>978,249,273</b>	<b>920,150,260</b>	<b>58,099,013</b>

**Llogaria 411 “Klientë e llogari të ngjashme”,** në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë.

**Llogaria 465 “Efekte për t’u arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë”,** në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë.

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”,** sipas të dhënave të pasqyrave financiare, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 907,716,343 lekë, me një rritje prej 74,598,536 lekë, krahasuar me vitin 2023, në të cilin vlera ka qenë 833,117,807 lekë. Gjatë viti 2024 është paguar për llogari të detyrimeve të trashëguara në datën 31.12.2023 si vijon:

- vlera 159,411,187 lekë për llogari të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore;
- vlera 200,000 lekë për llogari të detyrimeve të gjobave të IMT.

Janë krijuar debitorë të rinjë gjatë vitit 2024 si vijon:

- vlera 158,575,210 lekë për taksat dhe tarifatat vendore kategoria privat;
- vlera 12,480,000 lekë për gjobat e IMT;
- vlera prej 63,154,513 lekë, lënë në raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit më datë 29.04.2024, për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 15 subjekte.

**Për vlerat e debisë së kontabilizuar:** Debia si çelje në fillim të vitit 2024, pagesat e kryera, debitorët e vitit 2024, si dhe gjendja progresive e debitorëve në 31.12.2024, në mënyrë të përmblodhur jepen në tabelën e mëposhtme:

Detyrimi më 31.12.2023	Paguar gjatë vitit 2024 për llogari të debisë së trashëguar më 31.1.2023 (për taksat)	Paguar gjatë vitit 2024 për gjobat e IMT	Debia e krijuar gjatë vitit 2024			Detyrimi progresiv i kontabilizuar më 31.12.2024	Ndryshimi midis vitit 2024 me vitin 2023 (rritje/ulje e debitorve total)
			Për taksat dhe tarifatat vendore, kategoria privat	Për gjobat e IMT	Detyrime të lëna nga KLSH për TNI për 15 subjekte në raportin e auditimit datë 29.04.2024		

a	b	c	d	e	f	G=a-b-c+d+e+f	H=g-a
833,117,807	159,411,187	200,000	158,575,210	12,480,000	63,154,513	907,716,343	74,598,536

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Financës, vlera progresive 907,716,343 lekë përbëhet nga detyrimi prej 714,893,238 lekë për taksat dhe tarifave vendore nga subjektet private, detyrimet e lëna ndër vite nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në vlerën 114.548.525 lekë, si dhe vlera e pa arkëtuar e gjobave të IMT, prej 78,274,580 lekë.

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, në vlerën progresive të debitorëve për taksat dhe tarifave vendore prej 714,893,238 lekë, e cila është krijuar e gjitha nga kategoria e taksapaguesve privat, vlera 158,575,210 lekë i përket vitit 2024.

Sipas kësaj drejtorie, në datën 31.12.2023 kjo debi ka vlerën 715,729,215 lekë, për shlyerjen e së cilës janë kryer pagesa gjatë vitit 2024 në vlerën 159,411,187 lekë, krijuar debitorë të rinjë gjatë vitit 2024 në vlerën 158,575,210 lekë, duke bërë që detyrimi më 31.2.2024 të jetë në vlerën 714,893,238 lekë, sipas të dhënave të tabelës në vijim:

**Debia më 31.12.2024 vetëm për taksat dhe tarifave vendore, kategoria privat (e kontabilizuar):**

Detyrimi më 31.12.2023 (Për periudhën 2010-2023)	Paguar gjatë vitit 2024	Debia e të krijuar gjatë vitit 2024	Detyrimi më 31.12.2024	Ndryshimi midis vitit 2024 me vitin 2023 (rritje/ulje e debitorve)
715,729,215	159,411,187	158,575,210	714,893,238	(835,977)

Vlera totale vjetore e planifikuar nga të ardhurat dhe tarifave vendore është 370,000,000 lekë, ndërsa realizimi në vlerën 542,236,000 lekë, ose në masën 147%.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me shkresën nr. 2346 Prot., datë 28.03.2025 është përcjellë në Drejtorinë e Financës, lista e debitorëve progresiv për taksat dhe tarifave vendore, kategoria privat për 2578 debitorë (biznes i madhe dhe i vogël), në vlerën 714,893,238 lekë. Kjo listë përmban të dhënat e subjektit (emrin, NIPT, llojin e aktivitetit, etj.), si dhe vlerën progresive të debisë më 31.12.2024, por nuk jep të dhëna për vlerën e debisë që ka secili subjekt për llogari të vitit buxhetor 2024. Pra, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk administron listë të debitorëve privat, ku të evidentohet vlera e debisë që ka secili subjekt për detyrimet që lidhen vetëm me vitin buxhetor 2024, e si rrjedhojë kjo listë nuk administrohet as nga Drejtoria e Financës, përderisa nuk është krijuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore. Mos hartimi i listës së debitorëve të vitit, sipas emrave të subjekteve, vlerës së debisë për secilën lloj takse, nuk jep informacionin e nevojshëm për të shpjeguar dhe kuptuar në mënyrë analitike, për secilin subjekt vlerën përkatëse të debisë që ka krijuar gjatë vitit buxhetor, si dhe llojin e taksës dhe vlerën përkatëse të debisë për secilën lloj takse.

Për taksapaguesit familjarë për taksat dhe tarifave vendore (për taksën e ndërtesës, truallit, tarifën e ndriçimit, etj.), Bashkia Krujë nuk ka hartuar regjistër të taksapaguesve, nuk administron listë të debitorëve familjar as për debinë progresive dhe as për debinë e vitit buxhetor 2024, duke mos patur të dhëna për numrin e familjeve që kanë detyrim për të paguar, vlerën e detyrimit që kanë, si dhe numrin e familjeve që janë debitorë, vlerën e debisë dhe llojin e taksës për të cilin janë debitorë. Duke mos patur një planifikim që ti referohet listave konkrete të taksapaguesve, taksat e familjarëve planifikohen mbi bazën e vlerave të arkëtimeve të tyre në vitet e mëparshme.

Për taksën e tokës bujqësore lidhur me planifikimin e saj paraqitet e njëjta situatë. Kjo taksë nuk është planifikuar mbi bazën e listave konkrete të taksapaguesve, por mbi vlerën e arkëtuar të kësaj taksë në vitin paraardhës.

Nuk është ngarkuar me detyrim secili taksapagues sipas sipërfaqes së tokës, kategorisë, llojit të saj, etj, dhe sipas vlerës së detyrimit që ka mbështetur në paketën fiskale dhe mbi bazën e kësaj metodologjie të nxirrej vlera e nevojshme e planifikimit të të ardhurave. Ka evidencime vetëm të fermerëve të cilët kanë kryer pagesën e taksës, por duke qenë se nuk është ngarkuar me detyrimin vjetor fillestar secili fermer, nuk administrohen lista me emra konkret debitorësh, si diferencë e ngarkesës me detyrim në fillim të vitit, me pagesat e kryera gjatë vitit.

Regjistrat e taksapaguesve të taksës së tokës bujqësore për familjet fermerë nuk janë azhornuar në mënyrë të plotë dhe të saktë me të gjitha të dhënat e domosdoshme, (sipërfaqen, marrëdhëniet juridike me tokën, llojin e tokës bujqësore, kategorinë, nivelin e taksës së tokës të përlogaritur, këstet e parashikuara të pagesës të shtrirë gjatë vitit ushtrimor, pagesat e kryera, detyrimet e mbetura, nëse janë të kultivuar dhe me çfarë etj.).

Për taksën e tokës bujqësore për vitin 2024 vlera e planifikuar është 2,473,066 dhe vlera e realizuar është 2,323,814 lekë, ndërkohë që në vitin 2023 ka një planifikim të kësaj takse në vlerën 20,648,000 lekë, ose 8.3 herë më shumë se në vitin 2024.

Këto mangësi janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“, i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku thuhet: *“Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendor...”*. Gjithashtu mungesa e regjistrit të taksave vendore për subjektet familjar, nuk i krijon mundësi Bashkisë Krujë të evidentojë listën e familjeve të cilët bazuar në dispozitat në fuqi, përjashtohen nga detyrimi i pagesës së disa taksave dhe tarifave vendore. Këto mangësi janë në mos përputhje me kërkesat e ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“, i ndryshuar, neni 6 “Përjashtimi nga taksat”, ku thuhet: *“Përjashtohen nga taksat vendore të gjitha subjektet e parashikuara shprehimisht në këtë ligj apo në ligje të tjera të veçanta”*.

Mangësitë e mësipërme janë gjithashtu në mos përputhje me kërkesat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“, i ndryshuar, neni 23 dhe 24, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9.

Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, përveçse nuk kanë marrë masa për hartimin e regjistrit të taksapaguesve familjar, nuk kanë marrë masa që nëpërmjet miratimit të këshillit bashkiak, të bëhej përzgjedhja e agjentit fiskal për mbledhjen e detyrimeve për familjarët, praktikë e ndjekur nga shumica e bashkive në vend, të cilat kanë lidhur marrëveshje me shoqëritë e Ujësjellës Kanalizime, pasi këto institucione administrojnë listat e familjarëve për shkak të faturimit të ujit. Mos përcaktimi i agjentit fiskal, është në mos përputhje me kërkesa e ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“, i ndryshuar, neni 5, pika 2, ku thuhet:

*“Me përjashtim të te rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak:...ç) përcakton:...ii) mënyrën e mbledhjes së taksës, përfshirë zgjedhjen e agjentit fiskal dhe detyrimet e ndërsjellta”*.

Për mos hartimin e regjistrit të taksapaguesve familjar për taksat dhe tarifave vendore mban përgjegjësi, Kryetari i Bashkisë Krujë, znj. L.T., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për parregullsitë në planifikimin e taksës së tokës bujqësore, mos evidentimin e debitorëve me lista analitike dhe emra konkretë, mban përgjegjësi znj. E.D., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Tokës e Pronave (Kjo e fundit për mos hartimin e regjistrit të tatimit mbi tokën bujqësore).

Sipas rregullores së brendshme të Bashkisë Krujë “Mbi organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së bashkisë Kruje dhe njësisve administrative”,

Drejtoria e Menaxhimit të Tokave dhe Pronave „...është përgjegjëse për miradministrimin e çdo çështje që lidhet me veprimtarinë në fushën e buqesive dhe të mbrojtjes së tokës, ... mbledhjen e të dhënave për kadastrën vendore të tokave bujqësore”. Ndërsa sipas paketës fiskale *Struktura e përgjegjëse e ngarkuar për nxjerrjen e detyrimit dhe mbledhjen e të ardhurave të kësaj takse është po kjo drejtori.*

### **Debitorë të pa kontabilizuar, familjar dhe privat.**

Nr	Kategoria e taksapaguesve familjar. Lloji i taksës.	Vlera progresive e debisë së pa kontabilizuar më 31.12.2024	Debie e vitit 2024
1	Për taksat e tarifa vendore (Tokë bujqësore, taksë ndërtese, ndriçimi, etj.)	133,585,716	2,318,713
2	Për taksën e ndikimit në infrastrukturë (TNI)	58,519,368	
<b>3</b>	<b>Totali familjar</b>	<b>192,105,084</b>	<b>2,318,713</b>
	Kategoria e taksapaguesve privat. Lloji i taksës.		
	Pë licencat e karburanteve	2,200,000	2,200,000
	<b>Total privat pa kontabilizuar</b>	<b>2,200,000</b>	<b>2,200,000</b>
	<b>Total familjar + privat</b>	<b>194,305,084</b>	<b>4,518,713</b>

Edhe pse nuk ka regjistër të taksapaguesve familjar dhe listë debitorësh për familjarët, sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, ekzistojnë debitorë familjar të pa kontabilizuar, në vlerën progresive 192,105,084 lekë, prej së cilës vlera 133,585,716 lekë i përket detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore (tokë bujqësore, taksë ndërtese, ndriçimi, etj.), ndërsa vlera prej 58,519,368 lekë i përket detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë. Prej vlerës progresive 192,105,084 lekë, vlera 2,318,713 lekë i përket vitit 2024, detyrime për taksat dhe tarifave vendore (Jo TNI).

Theksojmë se kjo është një vlerë debitore jo reale, pasi nuk ka listë taksapaguesish familjar dhe as listë debitorësh, por kjo vlerë është nxjerrë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Menaxhimit Tokës e Pronave mbi bazën e diferencës së vlerës së planifikuar dhe asaj të realizuar. Kjo metodologji pune nuk është në përputhje me logjikën e metodologjisë për nxjerrjen e debitorëve.

Mos evidentimi i debitorëve familjar për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë edhe detyrimin për taksën e tokës bujqësore, bënë që edhe vlera e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në pasqyrën e pozicionit financiar të mos jetë e saktë.

### **Masat e marra nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e debitorëve:**

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, gjatë vitit 2024 për arkëtimin e debitorëve janë marrë këto masa:

### **1-Njoftimi për pagese vullnetare.**

Janë dërguar njoftimet për pagese vullnetare për detyrimet e prapambetura të gjithë subjekteve debitorë që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Bashkisë Kruje, me shkresat si më poshtë:

- Shkresat nr.1761/1-1761/1043 prot, datë 19.03.2024;
- nr 1762/1-1762/379prot date 19.03.2024;
- nr1892/1-1892/146prot date 26.03.2024;
- nr 1592/1-1592/445prot date 08.03.2024;
- nr153/1-1593/145 prot date 08.03.2024;

### **2- Lidhja e aktmarrëveshjeve për pagesat me këste.**

Për një numër të konsideruar debitorësh janë shqyrtuar dhe kërkesat e tyre, që në pamundësi financiare të pagesës totale të detyrimit kanë lidhur akt marrëveshje të pagesës me këste, bazuar në nenet 77, 78, 79, për marrëveshjet e pagesës me këste, e në vazhdim me Kreun IX, për mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore, të Ligjit Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Janë lidhur gjithsej 106 akt marrëveshje të pagesës me këste .

**3-Blokimet të llogarive bankare.** Me urdhrin nr 3854 prot date 19.06.2024 është dërguar pranë të gjithë bankave të nivelit të dytë “Urdhër bllokimi i llogarive” për subjektet debitor.

Nga borxhi tatimor me vlerë 911,869,731 leke (detyrimeve tatimore të prapambetura në total bashkia), ku nga këto 715,729,215 leke janë detyrime tatimore të prapambetura të subjekteve që i përkasin periudhës nga 1 janar 2010 deri me 31.12.2023, nga vlera e detyrimeve të prapambetura të subjekteve janë arkëtuar 159,411,187 lekë.

Për periudhën janar – dhjetor 2024 është bere e mundur mbledhja e detyrimeve të lëna nga KLSH për subjektet debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukture nga legalizimet në shumën 4,635,145 lekë, nga vlera e detyrimit të lenë 63,589,805 lekë.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Krujë në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar i ka dërguar njoftimet për detyrimet e lëna nga KLSH-ja, të gjithë subjekteve për tu pajisur me “Licensa për Tregtimin me pakice të lendeve djegëse” që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Bashkisë Krujë.

Për sa më sipër konstatohet se Bashkia Krujë nuk ka marrë masa të plota në rend shterues për arkëtimin e debitorëve, pasi në mënyrë të përmbledhur masat janë:

Njoftimi për pagesë vullnetare për detyrimin tatimor, lidhja e aktmarrëveshjeve për pagesat me këste dhe bllokimi i llogarive bankare.

Nuk është vijuar me masa të tjera shtrënguese të parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”. Për debitorët familjarë nuk ka lista konkrete dhe nuk ka masa konkrete nga strukturat e Bashkisë për arkëtimin e debitorëve.

Mos marrja e këtyre masave ngarkon me përgjegjësi kryetarin e Bashkisë z. A.B., drejtoreshën e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore znj. L.T., njëkohësisht në cilësinë e nëpunësit zbatues, znj. E.D., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit Tokës e Pronave (për debitorët e taksës së tokës bujqësore).

Pasqyra e gjendjes se subjekteve aktive për vitin 2024.

Nr	Lloji biznesit	Viti	Gjendja ne fillim	Regjistrime te reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja ne fund te periudhes 2024
1	Biznes i vogel	2024	1668	235	142	1761
2	Biznes i madh	2024	554	39	2	591
	Total		2222	274	144	2352

**Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”**. Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” (llogaritë e arkëtueshme), në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 70,532,930 lekë. Kjo llogari është “kundërparti”, apo përfaqëson llogaritë e klasës së 4 të pasivit të pasqyrës së pozicionit financiar (llogari të pagueshme) dhe rakordon me shumën e këtyre llogarive të pasivit si vijon:

Emërtimi i llogarive	Vlera
Llogari 401-408 “Furnitor e llogari të lidhura me to”	10,964,223
Detyrime ndaj personelit (Paga personeli llog 42)	33,907,604
Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa (Tatim mbi të ardhurat llog. 431)	3,932,406
Sigurime shoqërore llog.435	12,159,632
Sigurime shëndetësore llog.436	1,408,304
Kreditorë të ndryshëm llog. 467	8,160,761
<b>Totali</b>	<b>70,532,930</b>

Nga auditimi konstatohet se llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në vlerën 817,003,255 lekë.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 70,532,930 lekë. Kjo llogari kuadron me llogaritë e klasës 4 të pasivit për paga, sigurime, tatime dhe furnitorë (kreditor) të ndryshëm, por nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet në vlerën 817,003,255 lekë. Detyrimi i shtetit ndaj njësisë në vitin ushtrimor raportues (llog 4342), kërkon mbulim me fonde të këtij detyrimi në periudhat e ardhshme dhe, duhet të pasqyrohet në llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare. Parregullsia e mësipërme është në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe

konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32, ku thuhet:

*Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogaritë financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjsteve të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”).*

### **Aktivët Afatgjatë jomateriale (AAJM):**

**Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjatë Jomateriale”,** përbëhen nga llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit dhe paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 136,740,204 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 179,163,908 lekë. Sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 4,911,196,717 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,624,040,708 lekë, ku diferenca në rritje prej 712,843,991 lekë është krijuar gjatë vitit 2024.

Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

### **Inventari i llogarise 202 “Studime dhe kërkime”**

Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa 2024	Paksime 2024	Gjendja 31.12.2024
Studime dhe kërkime	136,740,204			136,740,204
Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme				
Studim projektim :Ndertim qendre rekreative dhe rikualifikim urban I parkut te rezervuarit Thumane		4,800,000		4,800,000
Hartim I projektit mbyllja dhe rehabilitimi I mbetjeve urbane nga venddepozitimi		425,655		425,655
Zbatim I projektit mbyllja dhe rehabilitimi I mbetjeve urbane nga venddepozitimi		37,198,049		37,198,049
<b>Totali</b>	<b>136,740,204</b>	<b>42,423,704</b>	<b>0</b>	<b>179,163,908</b>

Për këtë llogari Drejtorja e Financës nuk ka informacion të detajuar lidhur me listën e projekteve që përbëjnë vlerën 179,163,908 lekë, nuk ka inventar, si dhe nuk ka analizë të kësaj llogarie, regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv, mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve dhe viti i krijimit të tyre. Gjithashtu kjo drejtori nuk njeh se cilat janë projektet, investimet e të cilave kanë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim në mënyrë përfundimtare, si dhe përse vlera e projektit nuk është bashkuar me vlerën e investimit në llogarinë përkatëse të tij. Për sa më sipër llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, nuk jep një paraqitje të saktë të vlerës faktike të kësaj llogarie.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26, pika 30 dhe ngarkojnë me përgjegjësi drejtorin e financës z. E.F.

### **Aktivët afatgjatë materiale (AAM):**

**Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”,** në mbyllje të vitit 2023, paraqitet me vlerë neto 40,397,698 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 47,886,636 lekë. Sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjatë (kosto historike)”, në mbyllje të vitit 2023, paraqitet në vlerën 40,397,698 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 47,886,636lekë, ku diferenca në rritje prej 7,488,938 lekë është bërë gjatë vitit 2024 nga shpornësimi i zones 1/1 Thumane (toke truall) për saidin e ndertimit Thumanë.

### Inventari i llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*”:

Emërtimi	Celja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
Troje (Shpronësim në zonën 1/1 Thumane)	17,859,541			25,348,479
Sisteme dhe rregullime tokave	20,904,057			20,904,057
Te tjera	1,634,100			1,634,100
<b>Totali</b>	<b>40,397,698</b>	<b>7,488,938</b>	<b>0</b>	<b>47,886,636</b>

**Llogaria 211 “*Pyje, Kullota, Plantacione*”**, si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 19,804,270 lekë. Gjendja e kësaj llogarie, e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Celja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
Pyje, peme dekorative	16,024,850			16,024,850
Plantacione	3,779,420			3,779,420
<b>Totali</b>	<b>19,804,270</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>19,804,270</b>

**Llogaria 212 “*Ndërtesa dhe konstruksione*”**, në mbyllje të vitit 2023, paraqitet në vlerën 1,896,390,277 lekë dhe në mbyllje të vitit paraqitet 2024 në vlerën 2,322,778,021 lekë. Sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 2,472,322,344 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 3,010,425,653 lekë. Pra ka rritje në vlerën 538,103,309 lekë, që përbëhet nga shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM.

Gjendja e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Celja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
1	Ndërtesa administrative	273,180,352			273,180,352
2	Ndërtesa shkollore	1,440,733,322			1,440,733,322
3	Ndërtesa social kulturore	311,892,589			311,892,589
4	Ndërtesa shëndetësore	67,527,735			67,527,735
5	Ndërtesa të mbrojtjes civile	78,412,317			78,412,317
6	Konvikte nxënësish e studentesh	79,529,993			79,529,993
7	Lulishte	5,357,834			5,357,834
8	Varreza	10,086,296			10,086,296
9	Ndërtim mure rrethuese	1,085,838			1,085,838
10	Terrene sportive	28,739,645			28,739,645
11	Te tjera ndërtimore	175,776,423			175,776,423
12	Blerje stola për Bashkinë Krujë		295,200		295,200
13	Blerje shtylla për ndricimin rrugor me krahe		774,000		774,000
14	Ndërtim I atrium center Thumana , Nja Thumane		220,079,942		220,079,942
15	Mbikqyrje:Ndërtim I atrium center Thumana , Nja Thumane		1,695,073		1,695,073
16	Ndërtim I objektit të polit të ri administrativ , Nja Bubq		237,994,794		237,994,794
17	Mbikqyrje:Ndërtim I objektit të polit të ri administrativ, Nja Bubq		1,822,884		1,822,884
18	Rrethim e sistemim I varrezave Kraste		2,187,938		2,187,938
19	Mbikqyrje :Rrethim e sistemim I varrezave Kraste		55,360		55,360
20	Kolaudim :Rrethim e sistemim I varrezave Kraste		6,303		6,303
21	Rindertimi I shkolles 9 vjecare vellezerit Masha , Bubq		72,373,016		72,373,016
22	Mbikqyrje:indertimi I shkolles 9 vjecare vellezerit Masha , Bubq		818,799		818,799
	Amortizimi i llogaritur në total			687,647,632	-687,647,632
	<b>Totali</b>	<b>2,472,322,344</b>	<b>538,103,309</b>	<b>687,647,632</b>	<b>2,322,778,021</b>

**Llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”**, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 2,797,007,624 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 3,142,821,559 lekë. Sipas Formatit 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 3,540,722,066 lekë dhe në vitin 2024 paraqitet në vlerën 4,037,581,024 lekë. Pra ka rritje në vlerën 496,858,958 lekë, që përbëhet nga shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM.

Shtesat e kësaj llogarie janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Objekti	Data e hyrjes	Vlera
Shtim I sasise se furnizimit me uje te Qytetit Kruje	26.07.2024	376,513,855
Mbikqyrje :Shtim I sasise se furnizimit me uje te Qytetit Kruje		3,863,858
Sistemim asfaltim I rruges Abaze D Kastrioti	16.05.2024	3,501,768
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Abaze D Kastrioti		118,106
Sistemim asfaltim I rruges Kisha katolike Thumane	16.05.2024	2,627,328
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Kisha katolike Thumane		94,076
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges Kisha katolike Thumane		6,829
Sistemim asfaltim I rruges Leke Zaharia	16.05.2024	9,561,810
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Leke Zaharia		266,105
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges Leke Zaharia		21,122
Sistemim asfaltim I rruges Topalli Nikel	16.05.2024	5,697,060
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Topalli Nikel		187,129
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges Topalli Nikel		22,464
Sistemim asfaltim I rruges zeze, Nikel	16.05.2024	7,224,355
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges zeze, Nikel		189,397
Sistemim asfaltim I rruges vlash dobrozi dashamiri hekurudha	24.07.2024	16,638,358
Sistemim asfaltim I rruges superstrada Thumane	24.07.2024	18,844,206
Sistemim asfaltim I rruges 5 maji smt	24.07.2024	3,553,567
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges 5 maji smt		125,096
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges 5 maji smt		7,533
Sistemim asfaltim I rruges se Thanezes grumbullimi	03.05.2024	7,380,768
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges se Thanezes grumbullimi		216,854
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges se Thanezes grumbullimi		11,237
Sistemim asfaltim I rruges se Trojes Bushnesh	07.05.2024	6,188,148
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges se Trojes Bushnesh		157,953
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges se Trojes Bushnesh		22,745
Sistemim asfaltim I rruges se ukeve Tapize	07.05.2024	7,964,772
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges se ukeve Tapize		226,176
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges se ukeve Tapize		17,638
Sistemim asfaltim enegjelli Bilaj	07.05.2024	5,467,530
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim enegjelli Bilaj		172,172
Kolaudim:Sistemim asfaltim enegjelli Bilaj		12,533
Sistemim asfaltim I rruges Halil Zgerdhesh	07.05.2024	11,817,720
Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Halil Zgerdhesh		287,880
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges Halil Zgerdhesh		22,104
Sistemim asfaltim I sheshit pallati hark bloku 6	07.05.2024	3,116,376
Kolaudim:Sistemim asfaltim I sheshit pallati hark bloku 7		10,512
Sistemim asfaltim I rruges shkolla Bilaj	07.05.2024	2,888,196
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges shkolla Bilaj		8,138
Sistemim asfaltim I rruges se Baruneve	07.05.2024	1,794,748
Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges se Baruneve		10,736
<b>Totali</b>		<b>496,858,958</b>

Gjendja e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
1	Konstruksioni rrugeve	2,823,648,501			2,823,648,501
2	Konstruksioni urave	76,053,561			76,053,561
3	Konstruksioni I rrjeteve	101,821,756			101,821,756
4	Konstruksioni I veprave ujore	453,822,136			453,822,136
5	Te tjera per konstruksionin e rrugeve,urave,rrjeteve etj.	85,376,112			85,376,112
6	Shtim I sasise se furnizimit me uje te Qytetit Kruje		376,513,855		39,115,250
7	Mbikqyrje :Shtim I sasise se furnizimit me uje te Qytetit Kruje		3,863,858		133,651
8	Sistemim asfaltim I rruges Abaze D Kastrioti		3,501,768		395,190
9	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Abaze D Kastrioti		118,106		249,500
10	Sistemim asfaltim I rruges Kisha katolike Thumane		2,627,328		2,177,053
11	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Kisha katolike Thumane		94,076		403,994
12	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges Kisha katolike Thumane		6,829		122,600
13	Sistemim asfaltim I rruges Leke Zaharia		9,561,810		134,964
14	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Leke Zaharia		266,105		459,924
15	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges Leke Zaharia		21,122		88,320
16	Sistemim asfaltim I rruges Topalli Nikel		5,697,060		300,000

Nr.	Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
17	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Topalli Nikel		187,129		119,760
18	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges Topalli Nikel		22,464		65,099,231
19	Sistemim asfaltim I rruges zeze, Nikel		7,224,355		8,194,424
20	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges zeze, Nikel		189,397		33,479,619
21	Sistemim asfaltim I rruges vlash dobrozi dashamiri hekurudha		16,638,358		44,306,412
22	Sistemim asfaltim I rruges superstrada Thumane		18,844,206		272,500
23	Sistemim asfaltim I rruges 5 maji smt		3,553,567		370,455
24	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges 5 maji smt		125,096		311,962
25	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges 5 maji smt		7,533		389,952
26	Sistemim asfaltim I rruges se Thanezes grumbullimi		7,380,768		376,954
27	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges se Thanezes grumbullimi		216,854		397,580
28	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges se Thanezes grumbullimi		11,237		397,550
29	Sistemim asfaltim I rruges se Trojes Bushnesh		6,188,148		397,600
30	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges se Trojes Bushnesh		157,953		397,500
31	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges se Trojes Bushnesh		22,745		399,312
32	Sistemim asfaltim I rruges se ukeve Tapize		7,964,772		399,534
33	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges se ukeve Tapize		226,176		399,271
34	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges se ukeve Tapize		17,638		399,414
35	Sistemim asfaltim enegjelli Bilaj		5,467,530		399,853
36	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim enegjelli Bilaj		172,172		398,250
37	Kolaudim:Sistemim asfaltim enegjelli Bilaj		12,533		398,055
38	Sistemim asfaltim I rruges Halil Zgerdhesh		11,817,720		397,860
39	Mbikqyrje:Sistemim asfaltim I rruges Halil Zgerdhesh		287,880		397,932
40	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges Halil Zgerdhesh		22,104		398,445
41	Sistemim asfaltim I sheshit pallati hark blloku 6		3,116,376		398,250
42	Kolaudim:Sistemim asfaltim I sheshit pallati hark blloku 7		10,512		25,000,000
43	Sistemim asfaltim I rruges shkolla Bilaj		2,888,196		5,216,673
44	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges shkolla Bilaj		8,138		26,020,794
45	Sistemim asfaltim I rruges se Baruneve		1,794,748		13,081,866
46	Kolaudim:Sistemim asfaltim I rruges se Baruneve		10,736		3,754,113
	Amortizim I llogaritur			894,759,467	-894,759,467
<b>TOTALI</b>		<b>3,540,722,066</b>	<b>496,858,958</b>	<b>894,759,467</b>	<b>3,142,821,557</b>

**Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune”,** në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 23,882,790 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 4,636,804 lekë. Sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 83,408,811 lekë dhe në vitin 2024 paraqitet në vlerën 70,128,706 lekë.

Për vitin 2024 kjo llogari është shtuar në vlerën 5,928,960 lekë, për blerje me pagesë si më poshtë:

1. Blerje kontejnerë metalikë për Bashkinë Krujë 4,932,000 lekë.
2. Blerje kondicioner për nevojat e Bashkisë Krujë 897,480 lekë.
3. Blerje materiale elektroshtëpiake për kopshtet dhe çerdhet e Bashkisë Krujë 99,480 lekë.

Shtesat e kësaj llogarie janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Objekti	Data e hyrjes	Vlera
Blerje kontejnerë metalike per Bashkine Kruje	30.07.2024	4,932,000
Blerje kondicioner per nevojat e Bashkise Kruje	30.07.2024	897,480
Blerje materiale elektroshtepiake per kopshtet dhe cerdhet e Bashkise Kruje	22.08.2024	99,480
<b>Totali</b>		<b>5,928,960</b>

Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
1	Orendi dhe paisje mence	550,382			550,382
2	Paisje qe sigurojne energji	1,380,018			1,380,018
3	Instalim I sistemit te kompjuterave	34,746,999			34,746,999
4	Paisje dhe instalim I sistemit te kondicionerve	806,100			806,100
5	Makineri printimi dhe grafimi	1,467,259			1,467,259

Nr.	Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
6	Paisje pastrimi per rruget	11,952,298			11,952,298
7	Mjete dhe paisje te tjera teknike	32,505,755			32,505,755
8	Blerje kontejnere metalike per Bashkine Kruje		4,932,000		550,382
9	Blerje kondicioner per nevojat e Bashkise Kruje		897,480		1,380,018
10	Blerje materiale elektroshtepiake per kopshtet dhe cerdhet e Bashkise Kruje		99,480		34,746,999
	Amortizimi I llogaritur			84,700,967	-84,700,967
<b>TOTALI</b>		<b>83,408,811</b>	<b>5,928,960</b>	<b>84,700,967</b>	<b>4,636,804</b>

**Llogaria 215 “Mjete transporti”**, në mbyllje të vitit 2023, paraqitet në vlerën 25,469,096 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 20,375,276 lekë. Sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën prej 98,559,422 lekë dhe në vitin 2024 paraqitet në vlerën 98,559,422 lekë.

Për vitin 2024 nuk ka pasur shtesa në këtë llogari.

Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
1	Motorcikle	100,000			100,000
2	Makina	15,759,522			15,759,522
3	Autobuz	1,153,500			1,153,500
4	Kamione dhe mjete te renda	56,500,154			56,500,154
5	Ambulance	0			0
6	Zjarrfikese	25,046,246			25,046,246
<b>TOTALI</b>		<b>98,559,422</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>98,559,422</b>

**Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare, gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 105,844,962 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 63,338,142 lekë. Sipas Formatit nr. 7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 207,623,726 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën kontabël 186,285,899 lekë.

Në këto gjendje përfshihet pakësimi në vlerën prej 21,337,827 lekë si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit. Shtesa për vitin 2024 nuk ka pasur.

Gjendje e kësaj llogarie e analizuar sipas inventarit në vlerë bruto, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi	Çelja 01.01.2024	Shtesa 2024	Pakësime 2024	Gjendja 31.12.2024
1	Orendi zyre	161,544,515			161,544,515
2	Fotokopje	1,657,744			1,657,744
3	Paisje kompjuterike	8,647,143			8,647,143
4	Te tjera paisje zyre	35,774,324			35,774,324
	Nxjerrje jashte pendorimit			21,337,827	-21,337,324
	Amortizimi I llogaritur			122,947,757	-122,947,757
<b>Total</b>		<b>207,623,726</b>		<b>144,285,584</b>	<b>63,338,142</b>

Bashkia Krujë nuk ka regjistër kontabël për aktivet, ku të specifikohen në mënyrë analitike sipas llogarive përkatëse përshkrimi aktiveve, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, vlera fillestare, amortizimi, vlera e mbetur, etj. Gjithashtu në llogaritë e pasqyrave financiare nuk gjejnë pasqyrim

një numër i konsiderueshëm pronash të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi, apo përdorim të Bashkisë Krujë, por nuk janë ta pajisura me certifikatë pronësie, nuk janë vlerësuar dhe nuk janë kontabilizuar. Për këto arsye llogaritë e aktiveve afatgjata nuk pasqyrojnë vlerën reale të pasurisë së institucionit. Këto parregullsi janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (me ndryshime) pikat 26, 28, 30, Kreu IV, pika 75 dhe Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 5, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 24, pika 73 dhe 74, ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 12, pika 3.f.

**Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM”:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Krujë në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (1,554,041,620) lekë. Krahasuar me vitin 2024 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara”, paraqitet me shtesë prej (294,989,282) lekë, e cila ka ardhur si rezultat i shtesave në llogaritë e mëposhtme:

Llogaria 212: Ndertime e konstruksione	111,715,565 lekë
Llogaria 213: Rruge rrjete vepra ujore	151,045,026 lekë
Llogaria 214: Instalime teknike, pajisje, vegla pune	5,965,880 lekë
Llogaria 215: Mjete transporti	5,093,819 lekë
Llogaria 218: Inventari ekonomik	21,168,992 lekë
Pakësime të amortizimit nga lëvizja brenda aktiveve	
Llogaria 214: Instalime teknike, pajisje, vegla pune	19,209,065 lekë
Llogaria 218: Inventari ekonomik	21,337,827 lekë

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Krujë, janë si më poshtë:

Ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5%
Inventari ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi bazë grupimi)	20%
Pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25%
Mjetet e transportit	20%

**Llogaria 231 “AAGJM, Investime në proces”** në mbyllje të vitit 2023, paraqitet në vlerën 2,137,423,304 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 1,600,119,455 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor 2024.

Sipas burimeve të financimit, sipas Formatit nr. 6, paraqiten më poshtë:

Referencat e Llogarive	Emërtimi	Teprica në fillim të vitit	Transaksionet e vitit		Teprica në fund
			Debi	Kredi	
<b>I.</b>	<b>SHPENZIMET PER INVESTIME</b>	<b>2,137,423,304</b>	<b>0</b>	<b>-537,303,849</b>	<b>1,600,119,455</b>
230	Shpenzime per Aktive Afatgjata jo materiale	0			0
231	Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale	2,137,423,304	0	-537,303,849	1,600,119,455
25,26	Shpenzime per Aktive Afatgjata Financiare	0	0	0	0
25	Huadhenie dhe nenhuadhenie		0	0	0
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		0	0	0
<b>II.</b>	<b>BURIMET PER INVESTIME</b>	<b>2,137,423,304</b>	<b>0</b>	<b>-537,303,849</b>	<b>1,600,119,455</b>
105	1.Grante te brendshme kapitale	2,137,423,304	0	-537,303,849	1,600,119,455
1050	Grante kapitale nga Buxheti	2,137,423,304	0	-537,303,849	1,600,119,455
1051	Grante kapitale nga nivele te tjera	0	0	0	0

Referencat e Llogarive	Emërtimi	Teprica në fillim të vitit	Transaksionet e vitit		Teprica në fund
			Debi	Kredi	
1052	Kontribute te te treteveper investime	0	0	0	0
1059	Grante te brendeshme kapitale ne natyre	0	0	0	0
<b>106</b>	<b>2.Grante te huaja Kapitale</b>	0	0	0	0
1060	Nga qeveri te huaja	0	0	0	0
1061	Nga institucione nderkombetare	0	0	0	0
1069	Grante te huaja ne natyre	0	0	0	0
<b>14</b>	<b>3.Grante kapitale per investime per te trete</b>	0	0	0	0
145	Grante brendsh. kapitale per pjesm. ne invest. ne te trete	0	0	0	0
146	Grante te huaja kapitale per pjesm. ne invest. ne te trete	0	0	0	0
<b>11</b>	<b>4.Fonde te tjera te veta.</b>	0	0	0	0
111	Fonde rezerve	0	0	0	0
115	Caktim fondi per investime nga rezultati I vitit				0
116	Te ardhura nga Shitja e aktiveve te qendrueshme	0	0	0	0
<b>12</b>	<b>5.Rezultati I Mbartur</b>				
<b>16,17</b>	<b>6.Huamarrje</b>	0	0	0	0
<b>16</b>	Huamarrje e Brendshme	0	0	0	0
<b>17</b>	Huamarrje e Huaj	0	0	0	0
<b>III.</b>	<b>BALANCA</b>	0	0	0	0

### Konkluzion në lidhje me regjistrimin, vlerësimin dhe kontabilizimin e AAGJM:

Nga auditimi, u konstatua se nga Bashkia Krujë, në asnjë rast nuk janë bërë vlerësimet dhe kontabilizimet e AAGjM sipas vlerave fillestare të tyre (kosto historike/njohja fillestare), në momentin e kalimit të pronësisë, për të cilat gjithashtu nuk është llogaritur amortizimi. Bashkia Krujë ka kontabilizuar vetëm vlerat e shtuara ndër vite për mirëmbajtjen apo rikonstruksionet e ndryshme të AAGjM. Sa më sipër, është në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme””, kreu 2 “Trajtimi kontabël i AAGJM” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III dhe IV.

### PASIVET (DETYRIMET):

#### **Pasivet Afatshkurtra:**

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme. Ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Krujë më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2024, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

#### **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”**

Llogaritë	Emërtimi	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/ndryshimi
42	Detyrime ndaj personelit	33,907,604	26,515,461	7,392,143
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	3,932,406	2,595,717	1,336,689
435	Sigurime shoqërore	12,159,632	9,771,380	2,388,252
436	Sigurime shëndetësore	1,408,304	1,072,747	335,557
464	Detyrime për tu paguar për bl. letrave me vler	0	0	0
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	82,296,357	109,230,756	-26,934,399
467	Kreditorë të ndryshëm	8,160,761	38,911,325	-30,750,564
4341	Të tjera operacione me shtetin (detyrime)	907,716,343	833,177,807	74,538,536
475	Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse			
<b>Gjendja më fund të periudhës</b>		<b>1,049,581,407</b>	<b>1,021,275,193</b>	<b>28,306,214</b>

**Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”**, sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 33,907,604lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

<b>Çelje e vitit 2024</b>	<b>26,515,461</b>
Shtesa (K)	357,087,625
Pakësime (D)	349,695,482
<b>Gjendja në 31.12.2024</b>	<b>33,907,604</b>

Sipas dokumenteve të bankës të muajit janar 2025, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
1	15.01.2025	13,542,076
2	15.01.2025	11,986,944
3	15.01.2025	3,045,263
4	15.01.2025	2,615,759
5	15.01.2025	436,407
6	15.01.2025	2,281,155
<b>Totali</b>		<b>33,907,604</b>

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 2,765,403 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

<b>Çelje e vitit 2024</b>	<b>1,428,714</b>
Shtesa (K)	24,648,718
Pakësime (D)	23,312,029
<b>Gjendja në 31.12.2024 (K)</b>	<b>2,765,403</b>

Sipas dokumentave të bankës të muajit janar 2025, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
8	15.01.2025	2,765,403
<b>Totali</b>		<b>2,765,403</b>

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2024 që paguhen në muajin janar 2025 dhe janë përkatsisht në vlerat 10,185,628 lekë dhe 1,408,304 lekë.

Llog. 435 “Sigurime shoqërore”	
<b>Çelje e vitit 2024</b>	<b>7,797,376</b>
Shtesa	106,423,300
Pakësime	104,035,048
<b>Gjendja në 31.12.2024</b>	<b>10,185,628</b>
Llog. 436 “Sigurime shëndetësore”	
<b>Çelje e vitit 2024</b>	<b>1,072,747</b>
Shtesa	14,669,052
Pakësime	14,333,495
<b>Gjendja në 31.12.2024</b>	<b>1,408,304</b>

Sipas dokumentave të bankës të muajit janar 2025, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
7	15.01.2025	4,001,933
11	15.01.2025	6,183,695
<b>Totali</b>		<b>10,185,628</b>

**Llogaria 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”**, përfshin detyrimet e letrave me vlerë që janë furnizuar dhe nuk janë përdorur deri në fund të vitit 2024, për vlerën 0 lekë, lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten si më poshtë:

<b>Çelje e vitit 2024</b>	<b>0</b>
---------------------------	----------

Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
<b>Gjendja në 31.12.2024 (K)</b>	<b>0</b>

**Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”**, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 109,230,756 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 82,296,357 lekë.

**Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”**, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve në masën 5% të vlerës së kontratës për 52 objekte, në vitin 2024 ka vlerën 82,296,357 lekë, prej së cilës vlera 24,336,448 lekë i përket vitit 2024, për 30 objekte. Në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 109,230,756 lekë.

Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, e cila paraqitet, në aneksin bashkangjitur raportit të auditimit.

Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, Bashkia Krujë nuk ka hartuar plane mbarështimi për ekonomitë pyjore.

Në kundërshtim me pikën 66 të VKM-së nr. 443/2016 nuk ka regjistruar në regjistrat kadastrale sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullësor publik. Nuk është regjistruar asnjë sipërfaqe pyjore e transferuar.

Në kundërshtim me VKM-në nr. 171, datë 18.3.2022 “Për ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor dhe regjistrin e fondit kullësor, përcaktimin e strukturës, kritereve teknike për evidentimin dhe pasqyrimin e gjendjes dhe të ndryshimeve, mënyrës së mbajtjes së të dhënave në nivel vendor, rajonal e qendror, informacionit që duhet regjistruar, si dhe të afateve të përgatitjes e raportimit nga administratorët ose pronarët e pyjeve”, Bashkia Krujë nuk ka ngritur dhe përditësuar regjistrin për fondin pyjor brenda juridiksionit të saj administrativ.

Krahas sa më sipër, në lidhje me tokat e zaptuara dhe pronat e shkatërruara apo të dëmtuara, nga Bashkia Krujë nuk është ngritur asnjë padi penale, në kundërshtim me Ligjin nr. 7895 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, nenet 150-161 “Shkatërrimi i pronës” dhe neni 200 “Pushtimi i tokës”. Gjithashtu, të gjithë personat të cilët kanë pasur të bëjnë me procesin e regjistrimit dhe transferimit të pasurive publike nga qeverisja qendrore në Bashkinë Krujë (përfshirë ish Bashkinë Fushë Krujë dhe ish komunat e konsoliduara në Bashkinë Krujë), duke filluar nga personat të cilët kanë përpiluar listat fillestare të pasurive publike, personat punonjës në institucionet të cilët kanë bërë përpunimin e këtyre listave dhe deri të Këshilli i Ministrave i cili ka transferuar pasuritë publike nëpërmjet VKM-ve, duke mos bërë asnjë lloj referimi për tokat e zaptuara dhe pronat e shkatërruara apo të dëmtuara në organet ligjzbatuese, janë në shkelje të Ligjit nr. 7895 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, neni 300 “Moskallëzimi i krimi”.

Për pjesën më të konsiderueshme të pronave dhe të territorit të Bashkisë Krujë, me 5 VKM të posaçme, duke filluar nga viti 2008 e në vijim, është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Krujë. Ky proces ka përfunduar për Bashkinë Krujë, sipas VKM-në nr. 242, datë 06.03.2009, nëpërmjet të cilës janë transferuar 54 prona, për ish Bashkinë Fushë-Krujë, sipas VKM-së nr. 1264 datë 17.09.2008, transferuar 28 prona, për ish Komunën Thumanë, sipas VKM-së nr. 454 datë

06.05.2009, transferuar 49 prona, për ish Komunën Nikël, sipas VKM-së nr. 109 datë 17.02.2010, transferuar 32 prona, për ish Komunën Bubq, sipas VKM-së nr. 712 datë 20.10.2011, transferuar 16 prona. Për të gjitha pronat e transferuara me VKM sipas listës përfundimtare, Bashkia Krujë ka patur detyrimin për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe ligjor, për vijimin e procesit të regjistrimit të tyre në ASHK, me qëllim pajisjen e çdo prone me certifikatë pronësie në emër të Bashkisë Krujë, vlerësimin e saj në vlerë dhe regjistrimin në kontabilitet. Konstatohet se nuk janë marrë masat e duhura për këtë proces, pasi deri në datën 31.12.2024, janë të pajisura me dokument pronësie, vetëm 12 prona, por edhe këto nuk janë vlerësuar dhe nuk janë rregjistruar në kontabilitet. Për vitin 2024 është kryer aplikim në ASHK vetëm për 1 pronë (“Qendra kulturore”), ndërkohë që numri i pronave për të cilat duhej aplikuar nga Bashkia Krujë në ASHK është i konsiderueshëm. Gjatë vitit 2024 nuk është pajisur me dokument pronësie asnjë pronë.

Për ish Komunën Cudhi, nuk ka miratim të listës përfundimtare të pronave, por është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore në juridiksion territorial të Njësisë Vendore Cudhi, me VKM nr. 422 datë 08.04.2008. Prej këtij momenti nuk janë kryer veprime të tjera nga Bashkia Krujë, për të vijuar me fazat e tjera (hartimin e listës paraprake dhe listës përfundimtare e transferimit), me qëllim miratimin me VKM të një liste përfundimtare dhe rregjistrimin e tyre në ASHK.

Këto parregullsi janë në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” pikat 10, 11, 12, 21, 22, ligjin nr. 8744 datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike” nenet 35-44.

Për parregullsitë e konstatuara në fushën e pronave ngarkohen me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. A.B., drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Tokës dhe Pronave znj. E.D., përgjegjësi i Sektorit të Pyje-Kullotave z. F.M.

Lidhur me trajtimet e mësipërme, nëpërmjet postës elektronike, me shkresën nr. 7255 prot., datë 18.09.2025, janë dhënë disa shpjegime plotësuese nga znj. E.D., si vijon:

*Përsa trajtuar faqe 52-53 (Projekt Raporti i Auditimit).*

#### **Shpjegime:**

Aplikuar për të çertifikuar objektin “Qendër kulturore “Krujë” me shkresën nr.3566 prot. datë 06.06.2024.

Ngritur grupi i punës me nr.637 datë 27.12.2024, nr.9430 prot. datë 27.12.2024.

Dërguar informacion Kryetarit të Bashkisë me shkresën nr.4036 prot. datë 04.06.2025.

Dërguar shkresa nr.6345 prot. datë 20.08.2025 për ASHK.

Aplikuar me nr.64867 datë 21.08.2025 dhe bërë pagesa për shkresën e dërguar në Ashk.

*Përsa trajtuar faqe 55(Projekt Raporti i Auditimit).*

#### **Shpjegime:**

Dërguar shkresa nr.3299 prot. datë 28.05.2024 për Ashk Krujë, ku sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 2006 “ Për sistemimin e taksave vendore” i ndryshuar , neni 24, “Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave.”, si dhe ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, është kërkuar informacion për

azhornimin e listave të fermerëve që disponojnë tokë bujqësore në të gjitha zonat kadastrale të Bashkisë Krujë, duke qenë se të dhënat që disponojnë Njësitë Administrative janë të dhëna fillestare.

Ngritur grupi i punës me nr.309 datë 25.07.2024, nr.4776 prot. datë 25.07.2024 me specialist nga Drejtoria e Menaxhimit të Tokës dhe Pronave dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Dërguar shkresa nr. 5946 prot. datë 20.09.2024 për ASHK Krujë (e përsëritur).

Shkresa nr.5173/2 prot. datë 02.10.2024 për ASHK Krujë.

Shkresa nr.6485 prot. datë 07.10.2024 për ASHK Krujë (në bashkëpunim me D.T.T.V).

Ngritur grupi i punës me nr.374 datë 26.09.2024, nr.6074 prot. datë 26.09.2024.

Aplikuar në e-albania me nr.6188 datë 19.11.2024 dhe bërë pagesa për shkresat e dërguara.

### **Pika 3 e programit të auditimit. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

Në bazë të programit të auditimit nr. 615/1, datë 30.05.2025, me objekt: “Auditim financiar në Bashkinë Krujë”, u auditua pika 3 e Programit të Auditimit, “Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”.

Bashkia Krujë është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas programit tematik të auditimit nr. 854/4 prot., datë 24.06.2024 i ndryshuar, për pasqyrat financiare të vitit 2023.

Në përfundim të auditimit, për përmirësimin e gjendjes me shkresën nr.854/24 Prot., datë 14.10.2024, janë dërguar rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Në zbatim të rekomandimeve të dërguara, Bashkia Krujë me shkresën Nr. 7141, Prot., datë 24.10.2024, ka hartuar “Planin e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve”, ku janë përcaktuar strukturat përkatëse për zbatimin e çdo rekomandimi të dhënë në raportin e auditimit. Me shkresën Nr. 7140 Prot., datë 24.10.2024, Bashkia Krujë ka njoftuar Kontrollin e Lartë të Shtetit për hartimin e planit të veprimit.

Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	5	5	0	1	0	2	2
Masa shpërblim dëmi	0	0	0	0	0	0	0
Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.	1	1	0	1	0	0	0
Masa për arkëtimin e detyrimeve për debitorët.	1	1	0	0	0	1	0
<b>Totali</b>	<b>7</b>	<b>7</b>	<b>0</b>	<b>2</b>		<b>3</b>	<b>2</b>
Masa disiplinore	0	0	0				

Për përmirësimin e gjendjes janë dhënë 5 rekomandime organizative, 1 rekomandim për rubrikën “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara”, si dhe 1 rekomandim për rubrikën “Masa për arkëtimin e detyrimeve për debitorët”.

Në mënyrë të detajuar zbatimi i rekomandimeve rezulton si vijon:

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Krujë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerës së llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës

Financiare, e cila paraqitet e mbivlersuar për vlerën 726,666,028 lekë, për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

Zbatimi i rekomandimit nga subjekti: Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 70,532,930 lekë. Kjo llogari kuadron me llogaritë e klasës 4 të pasivit për paga, sigurime, tatime dhe furnitorë (kreditor) të ndryshëm, por nuk kuadron me llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet në vlerën 817,003,255 lekë.

#### **Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pa zbatuar**

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë, të marrin masa për mbylljen e procesit të inventarizimit të aktiveve të veta, të analizojë dhe të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Zbatimi i rekomandimit nga subjekti: Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se është përfunduar inventarizimi i vitit 2023 (trajtuar gjerësisht në pikën e pasqyrave financiare), por nuk është bërë analiza dhe të kryeja zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### **Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces zbatimi.**

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Krujë, të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Zbatimi i rekomandimit nga subjekti: Nga Drejtoria e Financës është parashikuar në buxhet fondi me emërtimin “Regjistrim pronash”, në vlerën 385,000 lekë, por ky fond nuk është shpenzuar, pas nga Drejtoria e Pronave për vitin 2024 është përgatitur dokumentacioni dhe është aplikuar në ASHK vetëm për rregjistrimin e një prone.

#### **Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces zbatimi.**

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Krujë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive 431 “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, duke paksuar ë vlerën 1,167,003 lekë dhe llogarinë 435 “Sigurime shoqërore”, duke e paksuar për vlerën 1,974,004 lekë, që janë vlera të mbartura nga periudha të kaluara, për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

Nga auditimi i pasqyrave financiare nuk janë konstatuar mangësi në paraqitjen e vlerave në llogarinë 431 “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”.

#### **Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar.**

**5.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Krujë, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë (vlera 71,697,460 lekë), për të cilat nuk ka dokumentacion për përfitimin e tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

Nga auditimi i pasqyrave financiare, u konstatua se situata në vitin 2024, është e njëjtë me atë të konstatuar në vitin 2023. (Trajtuar gjerësisht në pikën e pasqyrave financiare).

#### **Statusi i zbatimit të rekomandimit: I pa zbatuar.**

## **B.Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Krujë, të kontabilizojë vlerën prej 63,154,513 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet legalizimeve, me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj si dhe duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara.

Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se kjo vlerë është kontabilizuar.

**Statusi i zbatimit të rekomandimit: I zbatuar.**

## **D. Masa për arkëtimin e detyrimeve për debitorët.**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Krujë, të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën 833,117,807 lekë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se është arkëtuar vetëm vlera 159,411,187 lekë gjatë vitit 2024 për llogari të detyrimeve të debisë progresive prej 833,117,807 lekë, por nga Bashkia Krujë nuk janë ndërprerë përpjekjet për zbatimin e këtij rekomandimi, pasi ky është një proces në vijimësi.

**Statusi i zbatimit të rekomandimit: Në proces zbatimi.**

Si përfundim:

Bashkia Krujë është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas programit tematik të auditimit nr. 854/4 prot., datë 24.06.2024 i ndryshuar, për pasqyrat financiare të vitit 2023.

Në përfundim të auditimit, me shkresën Nr.854/24 Prot., datë 14.10.2024, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua si vijon: Janë dhënë gjithsej 7 rekomandime, prej të cilave 5 organizative, 1 për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara dhe 1 rekomandim për arkëtimin e detyrimeve për debitorët për vlerën 833,117,807 lekë. Të gjitha rekomandimet e dhëna janë pranuar nga subjekti. Nga 5 rekomandimet organizative 1 rezulton i zbatuar, 2 në proces zbatimi dhe 2 rekomandime të pa zbatuara. Rekomandimi për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, rezulton i zbatuar, ndërsa rekomandimi për arkëtimin e detyrimeve për debitorët rezulton në proces zbatimi, pasi prej vlerës 833,117,807 lekë,, është arkëtuar vlera 159,411,187 lekë.

Referuar të dhënave të mësipërme, konstatohet se nga Bashkia Krujë nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë Shtetit në auditimin e mëparshëm.

Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me ligji nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”. Për mos zbatimin e plotë të rekomandimeve ngarkohen me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. A.B., dhe Drejtori i Financës z. E.F.

#### IV. REKOMANDIME

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si vijon:**

##### B. MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për marrjen dhe dorëzimin e detyrës, dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës, pra të gjithë punën e krijuar prej tyre gjatë qëndrimit në institucion nga ana e punonjësve që ndërpresin marrëdhëniet e punës, fillojnë punë rishtas, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit. Gjithashtu nuk ka rregulla të shkruara dhe të miratuara nga titullari për ruajtjen e informacionit elektronik nga ana e punonjësve, gjë e cila ka të bëjë edhe me dorëzimin e këtij informacioni të eprori, apo punonjësi tjetër kur bëhen ndërprerja e marrëdhënieve të punës, apo lëvizjet brenda institucionit. Këto veprime nuk garantojnë ruajtjen e bazës së të dhënave, krijojnë vështirësi për vazhdimësinë e punës së kryer dhe transmetimin e saj nga një punonjës te tjetri dhe janë në kundërshtim me: Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 8, VKM nr. 171, datë 26.03.2014 ”Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, pika 50, Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 25. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë, nëpërmjet strukturës së burimeve njerëzore, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave të shkruara, lidhur me detyrimet që kanë punonjësit të cilët fillojnë punë rishtas, ndërpresin marrëdhëniet e punës, apo bëjnë lëvizje brenda institucionit, për marrjen dhe dorëzimin e detyrës me procesverbal, dorëzimin e dosjeve shkresore dhe dokumentacionit elektronik të krijuar gjatë punës së tyre në institucion.

*Deri më 31.12.2025*

**2.Gjetje nga auditimi:** Faqja elektronike e Bashkisë Krujë nuk funksionon, duke bërë të pamundur publikimin e dokumenteve zyrtare të bashkisë, e duke mos krijuar për qytetarët mundësinë e marrjes në mënyrë elektronike të informacionit për shërbime të ndryshme, për taksat vendore, për mbledhjet e këshillit bashkiak dhe vendimet e marra, shpenzimet e kryera për projektet publike, pasqyrat financiare, etj. Nga titullari nuk janë miratuar gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësive vendore dhe që sigurojnë që të gjitha operacionet e njësive publike, dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe strukturave mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 21, neni 16, pika 2 dhe 3. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përkatëse, të merren masa për vendosjen në funksionim të faqes elektronike të Bashkisë Krujë, me qëllim publikimin e dokumenteve dhe informacioneve të ndryshme, si dhe aksesimin nga ana e qytetarëve të këtyre informacioneve.

*Menjëherë*

**2.2.Rekomandim:** Nga të gjitha strukturat e Bashkisë Krujë në nivel drejtorie dhe sektori, të merren masa për hartimin e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës, si dhe ky dokument të miratohet nga titullari i institucionit.

*Deri më 31.01.2026*

**3.Gjetje nga auditimi:** Sektori i auditit të brendshëm të Bashkisë Krujë është i përbërë nga 3 punonjës të cilët nuk janë të pajisur me certifikatën e audituesit të brendshëm, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në ligjin nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, nenin 4 pika 7. Kjo mangësi nuk garanton cilësinë e duhur profesionale në kryerjen e detyrës së auditit të brendshëm. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.1, faqe 10-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si dhe nga vet punonjësit e auditit të brendshëm, të marren masa për pajisjen e audituesve me certifikatën e audituesit të brendshëm, me qëllim sigurimin e një cilësie sa më të lartë profesionale në proceset e auditimit.

*Deri më 31.03.2026*

**4.Gjetje nga auditimi:** Për pjesën më të madhe të pronave dhe territorit të Bashkisë Krujë, janë miratuar pesë Vendime të Këshillit të Ministrave, që nga viti 2008 e në vazhdim, përmes të cilave është përcaktuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i kalojnë në pronësi ose përdorim Bashkisë Krujë. Ky proces ka përfunduar për Bashkinë Krujë, sipas VKM-në nr. 242, datë 06.03.2009, nëpërmjet të cilës janë transferuar 54 prona, për ish Bashkinë Fushë-Krujë, sipas VKM-së nr. 1264 datë 17.09.2008, transferuar 28 prona, për ish Komunën Thumanë, sipas VKM-së nr. 454 datë 06.05.2009, transferuar 49 prona, për ish Komunën Nikël, sipas VKM-së nr. 109 datë 17.02.2010, transferuar 32 prona, për ish Komunën Bubq, sipas VKM-së nr. 712 datë 20.10.2011, transferuar 16 prona. Për të gjitha pronat e transferuara me VKM sipas listës përfundimtare, Bashkia Krujë ka patur detyrimin për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe ligjor, për vijimin e procesit të regjistrimit të tyre në ASHK, me qëllim pajisjen e çdo prone me certifikatë pronësie në emër të Bashkisë Krujë, vlerësimin e saj dhe regjistrimin në kontabilitet. Deri në datën 31.12.2024, janë të pajisura me dokument pronësie vetëm 12 prona, por edhe këto nuk janë vlerësuar dhe nuk janë reregjistruar në kontabilitet. Për vitin 2024 është kryer aplikim në ASHK vetëm për 1 pronë (Qendra kulturore), ndërkohë që numri i pronave për të cilat duhej aplikuar nga Bashkia Krujë në ASHK është i konsiderueshëm. Gjatë vitit 2024 nuk është pajisur me dokument pronësie asnjë pronë. Për ish Komunën Cudhi, nuk ka miratim të listës përfundimtare të pronave, por është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore në juridiksion territorial të Njësisë Vendore Cudhi, me VKM nr. 422 datë 08.04.2008. Prej këtij momenti nuk janë kryer veprime të tjera nga Bashkia Krujë, për të vijuar me fazat e tjera (hartimin e listës paraprake dhe listës përfundimtare e transferimit). Këto parregullsi janë në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” pikat 10, 11, 12, 21, 22, Ligjin nr. 8744 datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, nenet 35-44. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përkatëse që mbulojnë administrimin e pronave në bashki, për pronat të cilat kanë kaluar me VKM në pronësi, apo përdorim të Bashkisë Krujë, të marrin masa për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor dhe të kryejnë aplikimin

për regjistrimin e tyre në ASHK. Në vijim nga struktura e financës të bëhen regjistrimet në kontabilitet., bazuar në certifikatën e pronësisë. Për pronat e tjera të pa luajtshme, për të cilat me VKM është miratuar vetëm lista e pjeshme e inventarizimit, të vijohet për përfundimin e këtij procesi me fazat e tjera, me qëllim final, regjistrimin edhe të këtyre pronave në ASHK.

*Deri më 31.03.2026*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga Bashkia Krujë nuk janë bërë kontabilizimet e AAGjM sipas vlerave fillestare të tyre (kosto historike), në momentin e kalimit të pronësisë, për të cilat gjithashtu nuk është llogaritur amortizimi. Nuk është kryer inventarizimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, si dhe i aktiveve afatshkurtra për vitin ushtrimor 2024, pasi nga titullari i institucionit nuk ka dalë urdhër për këtë qëllim, duke mos u verifikuar saktësia e ekzistencës së tyre, cilësia e gjendjes fizike, si dhe përdorimi në mënyrën e duhur dhe me efikasitet. Mos kryerja e këtij procesi nuk garanton ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve kundrejt humbjeve, keq përdorimeve, apo përdorimit të pa autorizuar, duke mos u siguruar se vlerat kontabël të aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar, përputhen me vlerat dhe gjendjen fizike të tyre. Bashkia Krujë nuk ka hartuar regjistër kontabël për aktiveve. Gjithashtu në llogaritë e pasqyrave financiare nuk gjejmë pasqyrim një numër i konsiderueshëm pronash të cilat me VKM të posaçme kanë kaluar në pronësi, apo përdorim të Bashkisë Krujë, por nuk janë ta pajisura me certifikatë pronësie, nuk janë vlerësuar dhe nuk janë kontabilizuar. Për këto arsye llogaritë e aktiveve afatgjata nuk pasqyrojnë vlerën reale të pasurisë së institucionit. Këto parregullsi janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 24,26, 28, 30, 73, 74, Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II, pika 5, Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, neni 12, pika 3.f. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve çdo vit buxhetor, me qëllim garantimin, ruajtjen, mbrojtjen dhe sigurinë për ekzistencën e aktiveve.

*Në vijimësi*

**5.2.Rekomandim:** Drejtoria e Financës të marrë masa për hartimin e regjistrit të aktiveve, duke përcaktuar përshkrimin e aktivitetit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vitin e origjinës (hyrjes), etj.

*Deri më 31.03.2026*

**6.Gjetje nga auditimi** Në fund të vitit 2024 detyrimi i shtetit ndaj njësisë vendore për paga, sigurime, tatime dhe furnitorë (kreditor) të ndryshëm, ka vlerën 70,532,930 lekë, vlerë e pasqyruar në llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”. Kjo kërkon mbulim me fonde të këtij detyrimi në periudhat e ardhshme dhe duhet të pasqyrohet në llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare, por nga auditimi u konstatua se llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” ka vlerën 817,003,255 lekë, duke mos pasqyruar vlerën me të cilën do të financohet nga buxheti i shtetit në vitin 2025, për detyrimet e muajit dhjetor 2024, si dhe detyrimet e mbartura. Kjo parregullsi është në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 32. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës të marrë masa që në hartimin e pasqyrave financiare, të pasqyrojë në llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës

Financiare, vlerën e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, e cila përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, në fund të vitit buxhetor.

#### *Në mbyllje të pasqyrave financiare të vitit 2025*

**7.Gjetje nga auditimi:** Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, në pasqyrat financiare të viti 2024 ka vlerën 179,163,908 lekë, prej së cilës gjatë vitit 2024 është shtuar vlera 42,423,704 lekë. Për këtë llogari Drejtoria e Financës nuk ka informacion të detajuar lidhur me listën e projekteve që përbëjnë vlerën 179,163,908 lekë, nuk ka inventar, analizë të kësaj llogarie, regjistër kontabël ku të specifikohen të dhënat për secilin aktiv, mungojnë përshkrimet e studimeve dhe projekteve dhe viti i krijimit të tyre. Gjithashtu, kjo drejtori nuk disponon informacion të saktë mbi projektet dhe investimet që janë përfunduar dhe janë marrë në dorëzim përfundimisht, as mbi arsyet pse vlera e projektit nuk është reflektuar në mënyrë të plotë në llogarinë përkatëse të investimit.

Për sa më sipër llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, nuk jep një paraqitje të saktë të vlerës faktike të kësaj llogarie, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 26, pika 30. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për verifikimin e çdo zëri të llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” dhe, pas identifikimit të investimeve të finalizuara për të cilat janë hartuar këto projekte, të kryejë regjistrimet kontabël, duke realizuar kapitalizimin e tyre në aktivet përkatëse.

#### *Deri më 31.12.2025*

**8.Gjetje nga auditimi:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve në masën 5% të vlerës së kontratës për 52 objekte, në vitin 2024 ka vlerën 82,296,357 lekë, prej së cilës vlera 24,336,448 lekë i përket vitit 2024, për 30 objekte.

Për këtë llogari Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Urbanistikës nuk kanë informacion të saktë për rastet e investimeve të cilave ju ka kaluar afati i garancisë së punimeve përcaktuar në kontratë, me qëllim xhirimin e fondeve në llogari të kontraktorit, nëse investimi nuk ka paraqitur probleme, apo për verifikimin e investimit nëse ka patur problematika gjatë periudhës së garancisë, me qëllim rakordimin dhe mbajtjen e vlerës që lidhet me problematikën e konstatuar. Kjo ka vështirësuar vendimmarrjen për xhirimin e fondeve të kontraktori, apo kalimin e tyre në llogari të Bashkisë Krujë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1.Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Urbanistikës të marrë masa për të përcaktuar qartë listën e investimeve për të cilat sipas kontratës së lidhur midis palëve, ju ka përfunduar afati i garancisë së punimeve, si dhe të përcaktojë nëse vlera e ngurtësuar duhet të kalojë në llogari të kontraktorit, apo në llogari të Bashkisë Krujë, nëse ka dokumentacion që gjatë fazës së garancisë së punimeve, investimi ka paraqitur problematika, duke mos plotësuar kriteret e ndërtimi sipas kontratës.

#### *Deri më 31.12.2025*

**9.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Krujë, për taksat dhe tarifatat vendore të taksapaguesve familjarë, nuk ka hartuar një regjistër të dedikuar të taksapaguesve dhe nuk administron një listë debitorësh familjarë, as për debinë progresive dhe as për detyrimet e vitit buxhetor 2024. Si pasojë, mungojnë

të dhënat mbi numrin e familjeve që kanë detyrime për pagesë, vlerën e këtyre detyrimeve, numrin e familjeve debitore, shumën totale të debisë dhe llojin e taksave për të cilat rezultojnë debitorë. Për shkak të mungesës së një planifikimi të mbështetur në lista konkrete të taksapaguesve, të ardhurat nga taksat familjare planifikohen bazuar vetëm në nivelin e arkëtimeve të realizuara në vitet e mëparshme. Për taksën e tokës bujqësore regjistrat nuk janë të azhornuar me të gjitha të dhënat e nevojshme. Edhe për këtë taksë planifikimi bëhet mbi bazën e vlerave të arkëtimeve të viteve të mëparshëm dhe jo mbi bazën e listës së fermerëve dhe sipërfaqes së tokës, duke bërë që të evidentohen vetëm fermerët që paguajnë, por jo debitorët konkret. Mos evidentimi i debitorëve familjar për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë edhe detyrimin për taksën e tokës bujqësore, bënë që edhe vlera e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, në pasqyrën e pozicionit financiar të mos jetë e saktë. Mungesat e mësipërme nuk i krijon mundësi Bashkisë Krujë të evidentojë listën e familjeve të cilët bazuar në dispozitat në fuqi, përjashtohen nga detyrimi i pagesës së disa taksave dhe tarifave vendore. Këto mangësi janë në mos përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4, pika 7, neni 6, neni 23 dhe 24, Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9. (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Krujë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, në përbërje të të cilit të jenë edhe specialist nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me qëllim hartimin e regjistrit të taksapaguesve familjar për tasat dhe tarifave vendore, për evidentimin e detyrimeve vjetore, pagesave të kryera prej tyre dhe listës analitike të debitorëve familjar për taksat dhe tarifave vendore.

*Deri më 31.12.2025*

**9.2.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Krujë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune, në përbërje të të cilit të jenë edhe specialist nga Drejtoria e Menaxhimit të Tokës dhe Pronave, me qëllim azhurnimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke evidentuar në regjister të gjithë elementët e nevojshëm, si sipërfaqen kategorinë e tokës, etj. Në vijim të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, duke u bërë mbi bazën e listës dhe detyrimeve faktike të fermerëve, si dhe të evidentohen debitorët me emra analitikë taksapaguesish.

*Deri më 31.12.2025*

**10.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Krujë është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas programit tematik të auditimit nr. 854/4 prot., datë 24.06.2024 i ndryshuar, për pasqyrat financiare të vitit 2023. Në përfundim të auditimit, me shkresën nr.854/24 Prot., datë 14.10.2024, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

Nga auditimi i zbatimit të këtyre rekomandimeve u konstatua si vijon: Janë dhënë gjithsej 7 rekomandime, prej të cilave 5 organizative, 1 për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara dhe 1 rekomandim për arkëtimin e detyrimeve për debitorët për vlerën 833,117,807 lekë. Të gjitha rekomandimet e dhëna janë pranuar nga subjekti. Nga 5 rekomandimet organizative 1 rezultoi i zbatuar, 2 në proces zbatimi dhe 2 rekomandime të pa zbatuara. Rekomandimi për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara, rezultoi i zbatuar, ndërsa rekomandimi për arkëtimin e detyrimeve për debitorët rezultoi në proces zbatimi, pasi prej vlerës 833,117,807 lekë, është arkëtuar vlera 159,411,187 lekë.

Referuar të dhënave të mësipërme, u konstatua se nga Bashkia Krujë nuk janë marrë masa të plota për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë Shtetit në auditimin e mëparshëm.

Mangësitë e mësipërme janë në kundërshtim me ligji nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”.

**10.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e mos zbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr.854/24 Prot., datë 14.10.2024, duke nxjerrë përgjegjësitë për këtë qëllim.

Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të 2 rekomandimeve të pazbatuara. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 48-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

*Deri më 31.12.2025*

### **C. MASA PËR ELEMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË TYRE, TË ARDHURAT E MUNGUARA**

**1.Gjetje nga auditimi:** Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” sipas të dhënave të pasqyrave financiare, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 907,716,343 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore dhe e kontabilizuar në pasqyrat financiare. Kjo vlerë ka një rritje prej 74,598,536 lekë, krahasuar me vitin 2023, në të cilin ka qenë 833,117,807 lekë. Sipas të dhënave të Drejtorisë së Financës, vlera progresive prej 907,716,343 lekë përbëhet nga detyrimi prej 714,893,238 lekë për taksat dhe tarifave vendore nga subjektet private, detyrimet e lëna ndër vite nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në vlerën 114,548.525 lekë, si dhe vlera e pa arkëtuar e gjobave të IMT-së, prej 78,274,580 lekë. Duke qenë se vlera e gjobave të IMT prej 78,274,580 lekë, me ndryshimet e fundit ligjore janë falur, vlera konkrete e debitorëve ndaj bashkisë është 829,441,763 lekë (vlerë debitorë e kontabilizuar, por e pa arkëtuar).

Gjatë viti 2024 është arkëtuar për llogari të debisë së trashëguar, vlera 159,611,187 lekë, por gjithashtu janë krijuar edhe debitorë të rinj në vlerën 234,209,723, si vijon:

-vlera 158,575,210 lekë për taksat dhe tarifave vendore kategoria privat;

-vlera 12,480,000 lekë për gjobat e IMT;

-vlera prej 63,154,513 lekë, lënë në raportin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit më datë 29.04.2024, për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 15 subjekte.

Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, me shkresën nr. 2346 Prot., datë 28.03.2025 është përcjellë në Drejtorinë e Financës lista e debitorëve progresiv kategoria privat për 2,578 debitorë (biznes i madhe dhe i vogël), në vlerën 714,893,238 lekë. Kjo listë analitike e debitorëve evidenton në total vlerat progresive e debisë, por jo vlerën e debisë që ka secili subjekt për detyrimet që i përkasin vetëm vitin buxhetor 2024, duke mos dhënë informacionin e nevojshëm në mënyrë analitike për secilin subjekt, për llojin e taksës dhe vlerën përkatëse të debisë që ka krijuar gjatë vitit buxhetor 2024. Bashkia Krujë nuk ka marrë masa të plota në rend shterues për arkëtimin e debitorëve, pasi në mënyrë të përmblëdhur masat janë: njoftimi për pagesë vullnetare për detyrimin tatimor, lidhja e aktmarrëveshjeve për pagesat me këste dhe bllokim i llogarive bankare.

Nuk është vijuar me masa të tjera shtrënguese të parashikuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XI. Për debitorët familjarë nuk ka lista konkrete dhe nuk ka masa konkrete nga strukturat e Bashkisë Krujë për arkëtimin e debitorëve. *(Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Krujë së bashku me strukturat përkatëse të institucionit, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore në rend shterues, për arkëtimin e vlerës progresive debitorë të kontabilizuar, prej 829,441,763 lekë.

*Deri më 31.03.2026*

**1.2. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të hartojë jo vetëm listë debitorësh për vlerën progresive të debisë, por edhe listë për debinin e krijuar vetëm gjatë vitit buxhetor, ku të evidentohet vlera e debisë që ka secili subjekt dhe lloji i taksës për të cilën është debitor.

*Deri më 31.12.2025*

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **Për punonjësit që janë në marrëdhënie pune, pjesë e shërbimit civil.**

Në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenit 15, ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58, “Llojet e masave disiplinore”, VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Krujë, që ti kërkojë komisionit disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënie e masës disiplinore nga “Vërejtje”, deri në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për punonjësit e mëposhtëm:

**1.Z.E.F.**, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Financës, si dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues, për mos hartimin e regjistrit kontabël të aktiveve, për parregullsitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare, , etj., në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 të MFE “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, për mos marrjen e masave të plota për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë Shtetit në auditimin e mëparshëm, trajtuar më gjerësisht në Raportin përfundimtar të auditimit, faqe 15-16, 23-29, 49-51.

**2. Znj.E.D.**, me detyrë drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit të Tokës dhe Pronave, për parregullsitë në planifikimin e taksës së tokës bujqësore, për mos hartimin e regjistrit të tatimit mbi tokën bujqësore, mos evidentimin e debitorëve me lista analitike, në kundërshtim me detyrat funksionale, për mos marrjen e masave për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor për regjistrimin e pronave në ASHK, në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, pikat 10, 11, 12, 21, 22, ligjin nr. 8744 datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, Ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV, trajtuar më gjerësisht në Raportin përfundimtar të auditimit, faqe 20-21, 47-48.

**3.Znj. L.T.**, me detyrë drejtore e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, për mos hartim të regjistrit dhe debitorëve të taksapaguesve familjar, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore “, i ndryshuar, neni 4, pika 7, neni 23 dhe 24, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9; Për mos marrjen e masave të plota në rend shterues për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Kreu XI, trajtuar më gjerësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, faqe 19-22.

#### **D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit që janë rekomanduar masat disiplinore, Bashkia Krujë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

**c.** Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

#### **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

